




**QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL**



**RAPORT I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**JANAR- QERSHOR 2009**

*Shtator, 2009*

## Fjala e Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal

*Viti 2009 është një vit i rëndësishëm për pushtetin lokal në Kosovë, për disa arsye. Komunitet e Republikës së Kosovës kanë hyrë në vitin 2009 me një paketë të plotë ligjore që rregullon çështjet e pushtetit lokal, duke pasur në këtë mënyrë hapësirën dhe mundësitë e duhura për të qeverisur sa më mirë në nivelin komunal.*

*Komunitet tejkaloan me sukses edhe çështjet që kishin të bënin me ndryshimin e organizimit, që pasoi me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu, gjatë këtij viti ka vazhduar edhe procesi i bartjes së kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal, duke i afruar shërbimet gjithnjë e më pranë qytetarëve.*

*Duke punuar me përgjegjësi të plotë dhe të vetëdijshëm për rolin thelbësor që pushteti lokal luan në rritjen e mirëqenies së qytetarëve, komunitet e Republikës së Kosovës kanë pasur një aktivitet të ngjeshur, që pasqyrohet në faqet e këtij raporti të funksionimit të komunitave për periudhën janar-qershor 2009. Për dallim nga raportet e mëparshme, formati i këtij raporti pasqyron të dhënat e komunitave në mënyrë të veçantë, duke rritur në këtë mënyrë sasinë e informacionit për komunitet në veçanti, por duke trajtuar edhe më shumë fusha të aktivitetit të komunitave.*

*Kuvendet e Komunitave, si përfaqësim i drejtpërdrejtë i vullnetit politik të popullit, kanë pasur aktivitet si në mbledhjet e Kuvendëve, ashtu edhe përmes Komitetëve të detyrueshme apo konsultative. Rregulloret, vendimet apo aktet e tjera juridike që kanë nxjerrë Kuvendet janë baza e gjithë veprimtarisë që pushteti lokal ushtron në dobi të qytetarëve. Mënyra e matjes së efikasitetit të administratës komunale në këtë raport është pasqyruar përmes pasqyrimin të kërkesave të qytetarëve në drejtoritë komunale. Po ashtu, në raport pasqyrohen të dhëna të hollësishme në lidhje me shpenzimet e buxheteve komunale, si dhe për realizimin e të hyrave vetanake të planifikuar.*

*Të drejtat e njeriut kanë qenë në qendër të vëmendjes së aktivitetëve të Komunitave, duke pasur dhe mbështetjen e vazhdueshme të MAPL në këtë drejtim. Njësitët e të drejtave të njeriut duhet të shndërrohen në garantë të zbatimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore, të të drejtave të fëmijëve në të gjitha komunitet e Republikës së Kosovës.*

*Shumë shpejt do të zhvillohen zgjedhjet lokale, të parat në Republikën e Kosovës. Të zgjedhurit në Kuvende dhe Kryetarët e Komunitave janë në përfundim të bilanceve të tyre në lidhje me punën e realizuar gjatë periudhës dyvjeçare të mandatit të tyre. Megjithëse jemi të ndërgjegjshëm për punën që është bërë, kemi edhe shumë obligime për të përmbushur dhe jam i bindur se në Kosovë tashmë janë hedhur bazat e një pushteti lokal që punon për një qeverisje efektive, në dobi të aspiratave integruese të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës.*

*Ky Raport gjashtëmujor do të shërbejë për të rritur edhe më tej transparencën e organeve komunale në raport me qytetarët, institucionet qendrore, partnerët dhe*

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

*organizatat ndërkombëtare, mjetet e informimit publik, duke përmbushur kështu dhe një nga detyrimet ligjore që ka MAPL për monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të Komunave.*

*Në fund, unë inkurajoj Komunitat që të vazhdojnë ushtrimin e kompetencave të tyre me përgjegjësi të plotë, duke përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe kushtetuese, në mënyrë që cilësia e qeverisjes lokale të rritet edhe më shumë. Në të njëjtën kohë, falenderoj edhe të gjithë ata që ndihmuan për hartimin e këtij raporti.*

*Sadri Ferati,  
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal*

## Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj ligjor, mbështet dhe mbikëqyr në vazhdimësi aktivitetet e Komunave në Republikën e Kosovës. Kjo konsiston në promovimin e qeverisjes së mirë, respektimin e parimeve demokratike sipas kushtetutës, ligjit dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Pushteti lokal në Kosovë ka njohur zhvillim të vazhdueshëm që pas vitit 1999, duke arritur deri në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës, kur u hodh edhe një hap tjetër i madh i reformës së pushtetit lokal dhe avancimit të autonomisë së Komunave.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Ky raport i funksionimit të Komunave për periudhën janar-qershor 2009 vjen si rezultat i detyrimit ligjor që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me Komunat, por edhe si një mjet tjetër për të shtuar transparencën në lidhje me aktivitetet e pushtetit lokal.

Raporti përfshin të dhëna të veçanta për secilën komunë në lidhje me funksionimin e Kuvendeve të Komunave, efikasitetin dhe azhuritetin e organeve administrative komunale, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe financat lokale, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet e komunave për këtë periudhë kohore.

Po ashtu, Raporti përmban edhe të dhëna të përgjithësuara krahasuese në lidhje me mbledhjet e Kuvendeve të Komunave, si dhe të hyrat dhe shpenzimet e Komunave për periudhën gjashtëmujore të raportimit.

Ky raport ka për qëllim të hulumtojë situatën aktuale dhe sipas të dhënave të grumbulluara të pasqyrojë gjendjen reale në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e Komunave.

Raporti përmban të dhëna për 30 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që megjithëse është dërguar pyetësori, nga komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit nuk kemi pasur të dhëna.

## Struktura e raportit

Raporti përmban hyrjen, metodologjinë e punës, raportin mbi secilën komunë, konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat mbi secilën komunë janë paraqitur duke pasur këtë radhitje:

- Të dhëna të përgjithshme mbi komunën;
- Funksionimi i Kuvendit të Komunës;
- Efikasiteti i administratës komunale;
- Të drejtat e njeriut në Komunë;
- Financat lokale.

Gjithashtu raporti përmban edhe të dhëna të përgjithësuara dhe krahasimore në lidhje me numrin e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, si dhe pasqyra e përgjithshme e shpenzimeve dhe të hyrat vetanake.

## Metodologjia e punës

Ky raport është rezultat i bashkëpunimit mes Departamentit për Vetëqeverisje Lokale të MAPL-së dhe Komunave të Republikës së Kosovës.

Hartimi i raportit ka kaluar përmes këtyre fazave:

### *Faza e parë:*

#### *Përgatitja e pyetësorit dhe dërgimi i tyre nëpër komuna*

Departamenti për Vetëqeverisje Lokale ka përgatitur një pyetësor për mbledhjen e të dhënave, që i është vënë në dispozicion të Departamenteve të tjera, kabinetit të Ministrit dhe projekteve ndërkombëtare që mbështesin MAPL-në, për të dhënë komentet dhe sugjerimet. Versioni final i pyetësorit ka përmbajtur pyetjet kryesore që lidhen me kompetencat e komunave, kryesisht të ndara në fusha sipas strukturës që ka raporti.

### *Faza e dytë:*

#### *Grumbullimi i të dhënave nga terreni*

Në një afat optimal kohor, komunat kanë pasur mundësinë të njihen me pyetësorin, ndërsa në datën e caktuar, në takim të përbashkët ndërmjet zyrtarëve të MAPL-së dhe Zyrtarëve të Komunave është plotësuar versioni final i formularit. Në këtë mënyrë, Komunat kanë pasur në dispozicion kohë të mjaftueshme që të paraqesin të dhënat e tyre.

Për funksionimin e Kuvendit të Komunës, të dhënat janë siguruar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Sa i përket të dhënave në lidhje me shërbimet administrative komunale është kontaktuar drejtori i Administratës dhe personelit. Në raste të caktuara dhe sipas nevojës janë aranzhuar edhe takime me drejtorë të tjerë të administratës së Komunës, sipas fushave specifike.

Të dhënat në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal janë marrë nga koordinatorët e njësive për të drejtat e njeriut në Komuna.

Në fund, zyrtari përgjegjës i Komunës, ka nënshkruar deklaratën e saktësisë së të dhënave.

### *Faza e tretë:*

#### *Verifikimi i të dhënave*

Pas grumbullimit të të dhënave është bërë sistemimi i tyre sipas fushave. Ndërsa të dhënat janë verifikuar dhe krahasuar edhe me raportet e monitorimeve të rregullta që realizojnë ekipet monitoruese të MAPL-së.

*Faza e katërt*

*Përgatitja e raportit*

Pas verifikimit të të dhënave në terren, janë bërë përmirësimet e nevojshme dhe është përgatitur versioni final i raportit. Versioni final nga Departamenti për Vetëqeverisje lokale i është vënë në dispozicion departamenteve të tjera dhe kabinetit të ministrit dhe i është lënë afat i arsyeshëm kohor për të dhënë komentet e tyre në draftin e raportit. Gjithashtu, me qëllim të evitimit të lëshimeve eventuale në statistikat dhe çështjet e tjera të përfshira në raport, ky version i është dërguar edhe komunave, në mënyrë që para se të bëhet publikimi i raportit, komunat të kenë mundësinë të bëjnë korrektimet eventuale. Pas kalimit të afatit kohor për të dhënë komentet nga komunat, raporti është dërguar në publikim.

**Lista e shkurtimeve:**

DVL - Departamenti për Vetëqeverisje Lokale

LVL - Ligji për vetëqeverisje Lokale

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

OJQ - organizatë jo qeveritare

NJDNJ - Njësitë për të drejtat e njeriut

NJDNJK - Njësitë për të drejtat e njeriut në Komuna

PAK - personat me aftësi të kufizuara

PNJK - Pilot Njësi komunale

UA - Udhëzim Administrativ

UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë



## Përmbledhje ekzekutive

Raporti i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës për periudhën janar-qershor 2009 vjen si rezultat i detyrimit ligjor që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me Komunat, por edhe si një mjet tjetër për të shtuar transparencën në lidhje me aktivitetet e pushtetit lokal.

Sigurimi i një qeverisje të mirë në nivelin vendor, ofrimi i shërbimeve për qytetarët, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të banorëve, krijimi i hapësirave për pjesëmarrje demokratike, respektimi i parimeve të sundimit të ligjit janë elementët thelbësorë që MAPL ka monitoruar dhe mbikëqyrur në vazhdimësi gjatë gjithë vitit.

Raporti përfshin të dhëna të veçanta për secilën komunë në lidhje me funksionimin e Kuvendeve të Komunave, efikasitetin dhe azhuritetin e organeve administrative komunale, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe financat lokale, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet e komunave për periudhën kohore të raportimit.

Po ashtu, Raporti përmban edhe të dhëna të përgjithësuara krahasuese në lidhje me mbledhjet e Kuvendeve të Komunave, si dhe të hyrat dhe shpenzimet e Komunave për periudhën gjashtëmujore të raportimit.

Raporti përmban të dhëna për 30 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që megjithëse është dërguar pyetësori, nga komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit nuk ka të dhëna.

## Struktura e raportit

Raporti i funksionimit të Komunave përmban hyrjen, metodologjinë e punës, raportin mbi secilën komunë, konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat mbi secilën komunë janë paraqitur duke pasur këtë radhitje:

- Të dhëna të përgjithshme mbi komunën;
- Funksionimi i Kuvendit të Komunës;
- Efikasiteti i administratës komunale;
- Të drejtat e njeriut në Komunë;
- Financat lokale;

Gjithashtu raporti përmban edhe të dhëna të përgjithësuara dhe krahasimore në lidhje me numrin e mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, si dhe pasqyrën e përgjithshme të shpenzimeve dhe të hyrave vetanake.

## 1. Funksionimi i Kuvendeve të Komunave

Shumica e Komunave janë brenda dinamikës së parashikuar për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale, në përputhje me nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Nga të gjitha Komunitet e Republikës së Kosovës, obligimin ligjor për mbajtjen e pesë mbledhjeve në gjashtëmujorin e parë nuk e kanë përmbushur: Obiliqi, Podujeva, Klinë, dhe Rahoveci të cilat kanë mbajtur nga 4 mbledhje dhe Shtërpca që ka mbajtur 2.

Komitetet e detyrueshme janë formuar gati në të gjitha komunat. Përjashtim bën komuna e Shtërpces, e cila nuk e ka formuar komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete. Gjithashtu, edhe komuna e Glllogocit nuk ka themeluar komitetin për komunitete. Aktivitetet më dinamik ka pasur Komiteti për Politikë dhe Financa për dallim nga komitete tjerat. Gjithashtu vërehet se Komunitet nuk kanë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Vetëm disa komuna kanë krijuar këto komitete, të cilat janë listuar si vijon: : Peja(4), Rahoveci, Gjakova, Prizreni, Kaçaniku(4), Obiliqi(4), Prishtina(5), Vitia (5).

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, një numër i Komunave nuk i kanë mbajtur tubime publike me qytetarët. Vetëm 22 Komuna kanë mbajtur tubime publike. Sipas të dhënave që janë siguruar nga Komunitet, komuna e Ferizajt, Istogut, Klinës, Mitrovicës, Pejës, Shtërpces, Shtimes dhe Skenderajt nuk kanë mbajtur tubime publike

Një numër i konsiderueshëm i Komunave kanë miratuar statutet e tyre dhe i kanë harmonizuar me LVL. Gjithashtu kanë pasur aktivitetet e tyre legjislative, megjithëse një numër i konsiderueshëm i Komunave akoma nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore. Për shembull, vetëm 16 komuna kanë miratuar rregulloret për përdorimin e gjuhëve dhe vetëm 20 Komuna, kanë miratuar rregulloren për transparencën e punës së Komunës.

Rregulloren për punën e kuvendit e kanë miratuar të gjitha komunat, me përjashtim të komunës së Shtërpces.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i komunave nuk janë të disiplinuar të zbatojnë rekomandimet e MAPL-së nga raporti i Komunave për vitin 2008, në aspektin e dërgimit të rregulloreve në MAPL, me qëllim të vlerësimit të lidhshmërisë. Me këtë rast, ekipet e monitorimit të MAPL-së rregullisht janë detyruar të bëjnë vizita në Komuna, me qëllim të mbledhjes së rregulloreve dhe vendimeve.

27 Komuna kanë krijuar këshillat komunal për siguri në bashkësi.

Një numër i konsiderueshëm i Komunave të Republikës së Kosovës, kanë miratuar planet për zhvillim social-ekonomik lokal. Nëntë Komuna nuk e kanë miratuar strategjinë, konkretisht, Komuna e Ferizajt, Fushë-Kosovës, Kaçanikut, Novobërdës, Prizrenit, Rahovecit, Shtimes, Shtërpces dhe Vushtrrisë. Nga të dhënat që MAPL ka në dispozicion, vihet re se nuk është përdorur metodologji unike për hartimin e strategjive për zhvillimin socio-ekonomik të Komunave.

## 2. Efikasiteti dhe azhuriteti i administratës së Komunave

Qëllimi kryesor i vlerësimit të efikasitetit dhe azhuritetit është njohja me gjendjen reale të organeve të administratës komunale në shqyrtimin e lëndëve në procedurë administrative.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, ka pasur një numër të përgjithshëm prej 121 866 kërkesash, të realizuara në masën rreth 95%.

Në krahasim me vitin 2008, ku ka pasur gjithsej 186 269 lëndë të shqyrtuara, gjashtëmujorin e parë të këtij viti ka pasur 65.42% të lëndëve të vitit 2008.

Një numër i konsiderueshëm i komunave, tek numri i kërkesave në procedurë administrative në shkallë të parë, kanë numëruar edhe dokumentet e gjendjes civile.

Në një masë të madhe, Komunat nuk kanë përmbushur rekomandimet e MAPL-së nga raporti i vitit 2008, për të respektuar procedurat që parashihen me Udhëzimin Administrativ për funksionimin e Zyrave pritëse.

Ndërkohë që në raport janë paraqitur të dhënat e detajuara për secilën komunë, sipas drejtorive përkatëse, si konkluzione të përgjithshme të shqyrtimit të të dhënave mund të themi:

Të dhënat në zyrën pritëse në shumicën e Komunave nuk azhurnohen me kohë;

Sistemi digjital (Intraneti) në zyrën pritëse në Komunë është i instaluar, por të dhënat nuk freskohen dhe ka vështirësi në kthimin e dokumentacionit në këtë zyrë;

Në librat e protokollit të shkurtër evidentohen pranimet e kërkesave, ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës, Libri i protokollit nuk plotësohet, por për kërkesat dhe parashtrësit e qytetarëve, mbahen libra të brendshëm nëpër drejtori;

Pavarësisht se përfaqësuesit e komunave, kanë nënshkruar deklaratën e saktësisë së të dhënave gjatë mbushjes së pyetësorëve në takimet e përbashkëta me ekipet e monitorimit të MAPL-së, gjatë evidentimit të gjendjes në terren, të dhënat kryesisht rezultojnë të pasakta;

## 3. Të drejtat e njeriut

Njësitet e të drejtave të njeriut janë funksionale në 30 Komuna të Republikës së Kosovës;

Zyrtarët e NJDNJK-së monitorojnë përputhshmërinë e respektimit të akteve komunale me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (një numër i konsiderueshëm kryen këtë përgjegjësi, mirëpo ka komuna që asnjëherë nuk janë angazhuar si: Novobërda).

NJDNJK-të Monitorojnë aktivitetet e komunës dhe këshillojnë zyrtarët komunal sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut;

Të gjitha komunat kanë hartuar planin e veprimit të përcjellë me koston financiare, mirëpo realizimi i këtyre planeve është i pjesshëm për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Të gjitha NJDNJK-të koordinojnë aktivitetet me departamentet komunale si me të gjitha drejtoratet komunale, zyrtarët komunal, institucionet qendrore, organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të lehtësimit të realizimit të objektivave të veta.

Kërkesat që u janë adresuar NJDNJK-së nga qytetarët më tepër kanë qenë kërkesa verbale sesa me shkrim. Kërkesat kanë qenë të ndryshme si: kërkesa për zgjidhjen e problemit të kujdesit prindëror (Istog), kërkesa për zgjedhjen e problemit të ndërprerjes së ndihmës sociale, kërkesa për rregullimin e dokumentacionit, kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit etj. Kërkesat apo ankesat që i janë adresuar NJDNJK-së, janë shqyrtuar nga njësi, pastaj janë adresuar në institucionet kompetente për zgjidhjen e atyre rasteve. Në të shumtën e rasteve rekomandimet e NJDNJK-së kanë gjetur mirëkuptim nga organet kompetente për zgjidhjen e atyre rasteve. Po ashtu palët janë ndihmuar nga njësi për paqartësitë e ndryshme me cilat ata janë përballur në kontekst të të drejtave të njeriut.

Pothuajse të gjitha komunat kanë publikuar aktivitetet e tyre.

Vështirësi kryesore e NJDNJK-ve komunale është përkrahja jo e mjaftueshme nga zyrtarët e lartë komunal, mungesa e një linje të veçantë buxhetore. Një vështirësi tjetër krijohet për shkak se zyrtarët e këtyre njësive, detyrat në lidhje me të drejtat e njeriut i kanë si detyra shtesë.

Këto komuna nuk e kanë dërguar raportin për funksionimin e njësive të të drejtave të njeriut: Shtime, Shtërpçë, Junik.

#### **4. Financat lokale**

Raporti pasqyron në mënyrë të detajuar për secilën komunë pasqyrën e shpenzimeve të buxhetit komunal për periudhën janar-qershor 2009, ndërkohë që jepet edhe masa e realizimit të të hyrave vetanake për secilën komunë. Po ashtu, në anekset e raportit jepet pasqyra e detajuar e përgjithshme e shpenzimeve të buxhetit sipas zërave, ashtu si dhe të hyrat vetanake.

Sipas të dhënave të free balancit të datës 06.07.2009, Komunitat e Kosovës për periudhën janar-qershor 2009, kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 102,203,971.11 €, ose 42% të buxhetit të planifikuar vjetor prej 243,400,000.00€.

Planifikimi në kategorinë e pagave dhe shtesave në shumën prej 126,080,232.00 € është shpenzuar në vlerë prej 63,811,447.18 €, ose 51% i nivelit vjetor; mallra dhe shërbime të planifikuara në vlerë prej 24,336,593.00 € janë shpenzuar në vlerë prej 10,188,435.02 € ose 42%, shpenzimet komunale të planifikuara në shumë prej 8,621,360.00 € janë shpenzuar në vlerë prej 3,599,376.46 €, ose 42 %; subvencione dhe transfere të planifikuara vlerë prej 3,091,985.00 € është shpenzuar në vlerë prej 2,059,962.3 € ose 67%; ndërsa shpenzime kapitale të planifikuara në vlerë prej 81,269,831.00 €, është shpenzuar 22,544,750.09 €, ose 28%.

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

Shikuar në tërësi, të gjitha kategoritë e buxheteve, në dispozicion të komunave në vitin 2009, në periudhën gjashtë mujore të këtij viti, janë shpenzuar në këtë nivel:

Kategoria ekonomike	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit
Rrogat dhe pagat	126,080,232.00	63,811,447.18	51
Mallrat dhe shërbimet	24,336,593.00	10,188,435.02	42
Shpenzimet komunale	8,621,360.00	3,599,376.46	42
Subvencione dhe transfere	3,091,985.00	2,059,962.36	67
Shpenzimet kapitale	81,269,831.00	22,544,750.09	28

Komunat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës gjashtëmujore të vitit 2009 kanë grumbulluar 20,146,616.83 € të hyra vetanake, ose 54.15% nga niveli i planifikuar vjetor (37,200,000.00 €).

Në këtë periudhë gjashtëmujore është inkasuar tatimi në pronë në shumë prej 5,490,139 €, që është një inkasim më i madh se në periudhën gjashtëmujore të vitit 2008 (5,128,674 €).

Gjithashtu, të hyrat komunale për leje ndërtimi kanë pasur një ndikim të madh në rritjen e të hyrave vetanake, ku për periudhën janar-qershor 2009 janë inkasuar në shumë prej 5,451,309 që është një inkasim më i madhe se në periudhën gjashtëmujore të vitit 2008 3,829,053€.

Komunat të cilat kanë realizuar më së shumti të hyra vetanake janë: Hani i Eleziti (95.96%), Lipjani (85.27%), Vushtrria (78.09%), Gllogoci (73.47%), Kaçaniku (76.05%), Vitia (62.94%), Fushë Kosova (69.02%), Kamenica (60.50%), Juniku (60.29), Vitia (62.94).

Ndërsa komunat që kanë realizuar të hyra vetanake në një shkallë të ulët janë; Shtërpcë (27.96%), Novobërda (33.99%) dhe Mamusha (16.09%),

## **Raportet e Komunave**

## KOMUNA E DEÇANIT

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Deçanit, ka një sipërfaqe prej 371km/2. Numri i popullsisë në këtë komunë sillet rreth 40.000 banorë. Kuvendi i Komunës së Deçanit numëron 31 anëtarë të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive komunale është 8, ndërsa numri aktual i stafit të lejuar në këtë komunë është 104.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Deçanit ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtë zakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjashtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Kuvendi i Komunës nuk ka themeluar Komitete Konsultative, në përputhje me nenin 73.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës së Deçanit ka organizuar tubime publike me qytetarët, si edhe ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative, si dhe Rregulloren komunale për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë, që janë pranuar kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës.

Në përputhje me nenin 38.2 dhe 59.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit.

Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna e Deçanit ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Deçanit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Deçanit nuk ka miratuar Strategjinë për zhvillimin social-ekonomik lokal

*Efikasiteti i organeve administrative.* Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet administrative të Komunës së Deçanit për gjashtëmujorin e parë është 1615 kërkesa, të shqyrtuara janë 1593 kërkesa ose 98.63% . Prej tyre:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** ka pranuar gjithsej 890 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara 890.

**Drejtoria e Financa Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pranuar gjithsej 166 kërkesa, kurse të shqyrtuara janë 161 kërkesa, të pashqyrtuara ende janë 5 lëndë.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pranuar gjithsej 457 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara 447 kërkesa të pashqyrtuara ende janë 10 lëndë.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë** - nuk ka pranuar kërkesa.

**Drejtoria për Rini dhe Sport** - nuk ka pranuar kërkesa.

**Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi:** ka pranuar gjithsej 10 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** ka pranuar gjithsej 35 kërkesa, të shqyrtuara 29, të pashqyrtuara ende janë 6 lëndë.

**Drejtoria për Inspektion:** ka pranuar gjithsej 57 lëndë, të shqyrtuara janë 56, e pashqyrtuar ende është 1 lëndë.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Deçanit është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë të certifikuar.

Kjo njësi nuk ka linjë të veçantë buxhetore, por aktivitetet e saj mbështeten përmes projekteve që financohen nga Kuvendi i Komunës apo donatorë të ndryshëm.

Njësia për të drejtat e njeriut ka marrë pjesë, si dhe ka organizuar vetë aktivitete që synojnë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kryesisht në fushat e barazisë dhe integritetit gjinor, mundësive të barabarta, të drejtave të fëmijëve dhe kundër diskriminimit.

Me qëllim realizimin e objektivave që dalin nga strategjitë dhe plani i veprimtimit për të drejtat e njeriut, janë organizuar aktivitete, projekte, tryeza, tubime me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve në fushën e barazisë gjinore, mundësive të barabarta, ndalimin e dhunës në familje, të drejtat e grave, kundër trafikimit me qenie njerëzore, mos braktisjen e shkollimit etj. Është e rëndësishme të përmenden edhe aktivitetet: “Kundër trafikimit me qenie njerëzore” dhe “Dhuna gjeneron Dhunë”.

Gjithashtu, gjatë periudhës së raportimit, është mbajtur një tryezë e përbashkët me gratë deputete Parlamentin e Kosovës dhe me gratë anëtare në Kuvendet e Komunave të Deçanit, Gjakovës dhe Prizrenit. Me këtë rast është diskutuar Ligji mbi zgjedhjet dhe çështja e kuotës për pjesëmarrjen e grave në organet e zgjedhura. Kuvendi i Komunës, ka përkrahur edhe HENDIKOS-in, si rezultat i tryezës së mbajtur në mars të vitit 2009. NJDNJK ka realizuar



biseda me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, lidhur me rreziqet nga dukuritë negative në shoqëri dhe familje. Janë vënë postera me mesazhe të qarta për mbrojtjen e viktimave "Lajmëroni Dhunën".

Kuvendi i Komunës ka ndërmarrë aktivitete edhe me rastin e shënimit të 1 Qershorit (ditës së fëmijëve), ku janë organizuar konkurse me vizatimet e fëmijëve dhe në fund janë shpërblyer me dhurata.

NJDNJK ka bërë vizita në shkolla dhe ka shpërndarë broshura për të drejtat e njeriut, e në veçanti për të drejtat e fëmijëve.

Ka pasur raste të braktisjes së shkollës nga fëmijët, mirëpo në sajë të një bashkëpunimi shumë të mirë ndërmjet organeve të shkollës dhe prindërve, një numër i konsiderueshëm nga kategoria e nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën, i janë rikthyer shkollës.

Është bërë promovimi i NJDNJK-së nëpër lagjet e banuara më komunitetin rom. Njëkohësisht, komunitetit RAE u janë shpërndarë broshurat dhe informatat e duhura për adresimin e shkeljeve eventuale të të drejtave të tyre.

Në komunën e Deçanit, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi.

Gjithashtu, Komuna siguron transport vetëm për nxënësit e komunitetit boshnjak, ndërsa për të tjerët nuk ka nevojë sepse shkollat janë shumë afër.

Ndonëse ka një bashkëpunim shumë të mirë me organet e komunës, NJDNJK merr pjesë pjesërisht në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës.

Gjithashtu, NJDNJK bashkëpunon me të gjitha strukturat komunale, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, organizatat ndërkombëtare si: OSBE, UNHCR dhe organizatat joqeveritare brenda komunës, OJQ-të e Gruas "Jeta", "Syri i Vizionit" etj.

**Financat lokale.** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Deçanit është 4, 239,773.00 Euro.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 1,712,367.81, ose 40%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 370,000.00 euro, ndërsa për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 163,887.07, ose 44.29%.

## Komuna e Dragashit

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Dragashit ka një territor prej 435 km/2 dhe përbëhet prej 36 fshatrash. Popullsia e komunës së Dragashit është rreth 41 000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 21 anëtarë. Numri i drejtorive komunale është dhjetë, ndërsa, numri i aktual i stafit të lejuar për administratën komunale është 106.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta. Gjatë kësaj periudhe, nuk është mbajtur asnjë mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu, janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pesë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas të dhënave të siguruara nga pyetësorët, nuk rezulton se Kuvendi i Komunës ka themeluar Komitetet Konsultative, në përputhje me nenin 73.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka organizuar tubime publike me qytetarët, si edhe ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative, si dhe Rregulloren komunale për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë, nuk ka informacion nëse ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës.

Në përputhje me nenin 38.2 dhe 59.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit, ndërsa Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna e Dragashit ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Dragashit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale.

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar Strategjinë për zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Dragashit ka dërguar raportin e trajtimit të kërkesave për dhjetë (10) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 1779 kërkesa, ndërsa të shqyrtuara janë 1752 kërkesa ose 98.48%

**Drejtorja e Administratës dhe e Personelit:** ka pasur gjithsej 745 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pasur gjithsej 135 kërkesa, prej tyre 125 janë shqyrtuar.

**Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër, Mbrojtje të Mjedisit, dhe Shërbim Pronësor Juridik:** ka pasur gjithsej 186 kërkesa, prej tyre 98 të shqyrtuara.

**Drejtorja për Arsim:** ka pasur gjithsej 420 kërkesa, të janë shqyrtuar.

**Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport** - s'ka pasur kërkesa të parashtruara në këtë periudhë kohore në këtë drejtori.

**Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** - s'ka pasur kërkesa të parashtruara në këtë periudhë kohore në këtë drejtori.

**Drejtorja për Ekonomi dhe Bujqësi:** ka pasur gjithsej 286 kërkesa, prej tyre 282 janë shqyrtuar.

**Drejtorja për inspektorat** - s'ka pasur kërkesa të parashtruara në këtë periudhë kohore në këtë drejtori.

**Drejtorja për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** ka pasur gjithsej 14 kërkesa, prej tyre 10 janë të shqyrtuara.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Dragashit është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë të certifikuar. Edhe pse NJDNJK është kompletuar me staf, zyrtarët që janë pjesë përbërëse e njësisë angazhimet në kuadër të NJDNJK-së i kanë si detyra shtesë.

Në lidhje me zbatimin e strategjive për të drejtat e njeriut, NJDNJK ka ndërmarrë aktivitete dhe ka realizuar projekte nga fushat si vijon: barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e komuniteteve, si dhe me informimin e qytetarëve lidhur me adresimin e ankesave të tyre.

Në fushën e barazisë gjinore, me qëllim krijimin e mundësive të barabarta për të dy gjinitë, NJDNJK ka ndërhyrë për përsëritjen e konkursit për drejtorë të shkollave, për faktin se nuk janë paraqitur kandidatë të gjinisë femërore dhe nga komuniteti pakicë.

Me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë, NJDNJK është në kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq, Hendikos-it, Qendrës për punë sociale etj. Gjithashtu zyrtarët e NJDNJK-së marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesit në panele intervistuese. Në komunën e Dragashit është miratuar rregullorja për të drejtat e fëmijëve.

Në lidhje me të drejtat e komuniteteve, NJDNJK vazhdimisht ka monitoruar ofrimin e shërbimeve nga të gjitha institucionet, në veçanti takimet e Kuvendit të Komunës, Komitetit për Komunitete, Bordit të Drejtorëve, Zyrës për Kthim, Zyrës së komuniteteve dhe punën e Drejtorive.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Të gjitha materialet, dokumentet, shkresat, rregulloret etj, përkthehen në gjuhët zyrtare. Përveç gjuhëve zyrtare, në këtë komunë është në përdorim zyrtar edhe gjuha boshnjake.

Komuna siguron transport për të gjitha komunitetet. Zyrtarët e NJDNJK marrin pjesë gjatë hartimit të politikave rregulloreve dhe udhëzimeve që nxjerrë kuvendi komunal.

NJDNJK është në fazën e zbatimit të planit të veprimit dhe strategjisë për të drejtat e njeriut. Njëkohësisht, bashkëpunon me të gjitha strukturat komunale, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare. Vështirësi për realizimin e punëve dhe detyrave paraqet puna shtesë e zyrtarëve të njësitit, buxheti i limituar, si dhe shkalla e ulët e bashkëpunimit me OJQ-të lokale.

***Financat lokale.*** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Dragashit është 3,725,280.00 Euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 1,270,395.98, ose 34%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 270,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 131,216.00 ose 48.60%.

## KOMUNA E FERIZAJT

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë përbëhet prej 44 fshatrave me qendër në Ferizaj, me një sipërfaqe prej 345 km/2. Komuna ka një popullsi prej rreth 160.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është njëmbëdhjetë, ndërsa numri aktual i stafit, i lejuar në administratën komunale është 202.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Ferizajt ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjashtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Ferizajt nuk ka ngritur Komitete Konsultative apo komitete të tjera.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Ferizajt nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Ndërkohë ende nuk është miratuar Rregullorja komunale për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës e kanë paraqitur konfliktin e interesit, ndërsa nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, edhe nga ana e kryetarit. Ndërsa, kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna e Ferizajt ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kjo komunë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komuna të tjera, me ndihmën e Agjencisë së Zhvillimit Regional. Po ashtu, komuna ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet brenda territorit të saj.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Ferizajt ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Ferizajt nuk ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e **Ferizajt** ka dërguar raportin për njëmbëdhjetë (11) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 7332 kërkesa, ndërsa prej tyre, të shqyrtuara janë 6764 kërkesa ose 92.25%.

**Drejtoria për Administratë dhe Personel** - janë pranuar gjithsej 2661 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 1919 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 1443 kërkesa, ndërsa 192 janë ende të pashqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim:** janë pranuar 273 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet:** janë pranuar 288 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 285 kërkesa ndërsa 3 ende nuk janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim:** ka pasur gjithsej 67 kërkesa, të shqyrtuara janë 40 kërkesa, ndërsa 27 ende nuk janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 1480 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:** ka pasur gjithsej 27 kërkesa, prej tyre 24 kërkesa janë të shqyrtuara, ndërsa 3 ende nuk janë shqyrtuara.

**Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport:** ka pasur gjithsej 65 kërkesa dhe të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** ka pasur gjithsej 50 kërkesa, të shqyrtuara janë 31 kërkesa, ndërsa 4 kërkesa janë të bartura nga viti paraprak, në shqyrtim janë 15 kërkesa.

**Drejtori e Inspeksionit:** ka pasur gjithsej 484 kërkesa, të shqyrtuara 447 kërkesa, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 37 kërkesa.

**Zyra komunale e Komuniteteve:** ka pasur gjithsej 18 kërkesa, prej të cilave 3 të bartura nga viti paraprak, 15 janë shqyrtuar, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Ferizajt është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë të certifikuar. Për dy nga zyrtarët, punët në këtë njësi janë si detyra shtesë. Nuk ka linjë të veçantë buxhetore për njësinë, mirëpo projektet mbështeten sipas kërkesave.

Me qëllim të zbatimit të objektivave që dalin nga strategjitë dhe planet e veprimeve për të drejtat e njeriut, njësiti ka realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme, fushata vetëdijesimi në zonat rurale, projekte për të drejtën e gruas në trashëgimi, fushata vetëdijesimi për rëndësinë e shkollimit të rinjve, veçanërisht vajzave të komunitetit RAE. Janë organizuar takime me stafin komunal dhe qytetarë të komunës dhe janë dhënë rekomandime për eliminimin e diskriminimit në fushën e arsimit etj.

Të gjitha dokumentet përkthehen në gjuhët zyrtare.

Për komunitetin serb komuna siguron transportin në mënyrë të plotë, kurse për komunitetet e tjera pjesërisht.

Në këtë komunë nuk ekziston një bashkëpunim i duhur në mes të NJDNJK-së dhe organeve tjera komunale si drejtorinë e administratës, zyrën ligjore dhe drejtoritë tjera. Mirëpo krahas kësaj njësitit bashkëpunon me organizata tjera si ato ndërkombëtare (OSBE-në, UNDP) ashtu edhe me OJQ-të vendore.

Vështirësitë e njësitit në lidhje me kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive konsistojnë në mungesën e një linje të veçantë buxhetore si dhe kohën e kufizuar të zyrtarëve për shkak të detyrave shtesë.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Ferizajt është 13,025,504.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 4,953,252.01 ose 38%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 1,914,130.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 1,127,614.08 ose 58.91%.



## KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Fushë Kosovës përbëhet prej 17 fshatrave me qendër në Fushë-Kosovë, me një sipërfaqe prej 100 km<sup>2</sup>. Popullsia prej rreth 50.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 21 anëtarë. Numri i drejtorive është shtatë, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 128.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtë zakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar katër mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dy mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Fushë Kosovës ka themeluar shtatë komitete konsultative, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, neni 73,1.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Fushë-Kosovës ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren komunale për gjuhët, por ende nuk ka miratuar Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit, ndërsa, Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna e Fushë-Kosovës ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Fushë-Kosovës ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës nuk ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.



*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Fushë Kosovës ka dërguar raportin për trajtimin e kërkesave në shkallë të parë, në procedurë administrative për shtatë (7) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 1485 kërkesa, ndërsa 1333 ose 89.76% prej tyre janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Administratë:** janë pranuar gjithsej 264 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 427 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 366 kërkesa, të pashqyrtuara 61.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit:** janë pranuar gjithsej 547 kërkesa, të shqyrtuara janë 547 kërkesa.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar gjithsej 32 kërkesa, prej tyre 32 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për inspektion:** janë pranuar gjithsej 10 kërkesa, të gjitha të miratuara.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** ka pasur gjithsej 18 kërkesa, janë shqyrtuar 13, 5 të pashqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 161 kërkesa, janë shqyrtuar 95, ndërsa të pashqyrtuara gjithsej 66.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Fushë-Kosovës është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë të certifikuar. Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve. NJDNJK në këtë komunë ka realizuar projekte sipas objektivave të parashikuara në Strategjitë dhe Planet e Veprimeve për të drejtat e njeriut.

Janë organizuar disa debate me qëllim të vetëdijesimit për respektimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Janë realizuar disa aktivitete me rastin e 1 Qershorit (Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve).

Në këtë Komunë, janë evidentuar raste të braktisjes së shkollës nga komuniteti RAE. Ligji Për të Drejtat e Komuniteteve zbatohet në tërësi. Është organizuar një kamping multietnik, i shoqëruar me aktivitete të ndryshme. Nuk ka pasur raste të shkeljes së të drejtave të minoriteteve. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve dhe ekziston edhe njësi për përkthim.

Komuna ofron transportin për të gjitha komunitetet, si dhe për personat me aftësi të kufizuara. NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal. Po ashtu NJDNJK monitoron në zbatimin e akteve të lartshënuara lidhur me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. NJDNJK ofron komentet lidhur me rregulloret, udhëzimet e zyrës ligjore në komunë, për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. NJDNJK bashkëpunon me drejtoritë e tjera, zyrën ligjore me struktura tjera të

nivelit komunal. NJDNJK bashkëpunon me organizata vendore dhe ndërkombëtare.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Fushë-Kosovës është 4,055,629.00 euro.

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 1,652,906.15 ose 41%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 650,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 448,659.91 ose 69.02%.

## KOMUNA E GLOGOCIT

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë përbëhet prej 42 vendbanimesh, me një sipërfaqe prej 290 km/2. Popullsia prej mbi 73.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës - 31 anëtarë. Numri i drejtorive - dhjetë. Numri i stafit të administratës komunale është 121.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtë zakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe asnjë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Glllogocit nuk ka ngritur komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Glllogocit ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Kuvendi i Komunës po ashtu ka miratuar dhe Rregulloren për të hyrat vetanake për vitin 2009.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur një kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Në komuna ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit. Kryetari i Komunës nuk ka raportuar para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave që MAPL ka në dispozicion.

Komuna e Glllogocit ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Glllogocit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar. Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Glllogocit, ka dërguar raportin për dhjetë (10) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 11.523 kërkesa, prej të cilave 11.126 ose 96% prej tyre janë trajtuar.

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 677 kërkesa, prej tyre 675 të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 8453 kërkesa prej të cilave 8320 janë të shqyrtuara, të refuzuara 122, të hedhura poshtë 11.

**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 155 kërkesa. Prej tyre 113 kërkesa janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 4.

**Drejtoria për Arsim:** janë pranuar gjithsej 41 kërkesa prej të cilave janë shqyrtuar, 11 të pashqyrtuara 30.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 1397 kërkesa, prej tyre 1377 të shqyrtuara, të refuzuara 11, të pashqyrtuara 9.

**Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pasur gjithsej 165 kërkesa, të pashqyrtuara 152, të refuzuara 4.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar gjithsej 135, kërkesa, prej tyre 124 të shqyrtuara, të refuzuara 9, të pashqyrtuara 1.

**Drejtoria e Kadastrës dhe Pronës:** janë pranuar gjithsej 441, kërkesa, prej tyre 363 të shqyrtuara, të refuzuara 34, të pashqyrtuara 4.

**Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sporte:** janë pranuar gjithsej 30 kërkesa, prej tyre 13 të shqyrtuara, të refuzuara 2, të pashqyrtuara 13.

**Drejtoria për inspektim:** janë pranuar gjithsej 43 kërkesa, prej tyre 38 të shqyrtuara, të refuzuara 11.

***Të drejtat e njeriut.*** Në Komunën e Glllogocit është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me dy zyrtarë. Gjatë periudhës së raportimit NJDNJK ka realizuar vetëm dy projekte: Shënimi i 1 Qershorit (Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve), ku janë shpërndarë broshura në shkolla fillore dhe të mesme për të drejtat e fëmijëve, si dhe organizimi i 8 Marsit. Mosrealizimi i projekteve arsyetohet me mungesën e mjeteve buxhetore. Si aktivitete kryesore të cilat njësit i ka realizuar për periudhën janar-qershor 2009 janë: debati me nxënës të dy shkollave të mesme për “Dukuritë negative në Shoqëri”, si dhe debati me nxënësit e katër shkollave për Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve. Komuna nuk ka njësit për përkthim, sepse nuk ka minoritete dhe nuk ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve. NJDNJK merr pjese gjatë hartimit të akteve komunale, si dhe monitoron zbatimin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

NJDNJK bashkëpunon me strukturat e nivelit komunal, me organizatat ndërkombëtare, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare.

***Financat lokale.*** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Glllogocit është 6,500,280.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 2,498,625.03 ose 38%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 464,350.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 341,875.88 ose 73.47%.

### **KOMUNA E GJAKOVËS**

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Gjakovës përbëhet prej 89 fshatrave me qendër në Gjakovë, me një sipërfaqe prej 586 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 150.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është trembëdhjetë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 209.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe katër mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Gjakovës ka ngritur komitetet konsultative, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, neni 73,1.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Gjakovës ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren komunale për gjuhët, Rregulloren për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa Kryetari i Komunës nuk ka pasur rast. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës.

Komuna e Gjakovës ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike. Kjo komunë ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi në sferën e zhvillimit ekonomik.

Komuna e Gjakovës ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Gjakovës ka dërguar raportin për trembëdhjetë (13) drejtori.

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 895 kërkesa, të shqyrtuara 642, të pashqyrtuara janë 253 lëndë.

**Drejtoria për Agrikulturë dhe Bujqësi:** janë pranuar gjithsej 45, të shqyrtuara janë 11 lëndë , ndërsa 34 të pashqyrtuara ende .

**Drejtoria për Arsim dhe Shkencë:** janë pranuar 281 kërkesa. Prej tyre 196 kërkesa janë të shqyrtuara, ndërsa të pashqyrtuara janë 85 lëndë.

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa:** ka pranuar gjithsej 329 kërkesa, të shqyrtuara janë 115, ndërsa të pashqyrtuara 214 lëndë.

**Drejtoria për inspektorat:** ka pranuar gjithsej 640 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara 198, ndërsa të pashqyrtuara 442 lëndë.

**Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport:** ka pranuar gjithsej 75 kërkesa, të shqyrtuara janë vetëm 3 kërkesa, ndërsa 72 janë të pashqyrtuara.

**Drejtoria për Mbrojtje Civile dhe Gatishmëri Emergjente:** ka pranuar gjithsej 112 kërkesa, të shqyrtuara janë 8, ndërsa 104 ende nuk janë shqyrtuar .

**Drejtoria për Punë Pasurore Juridike:** ka pranuar gjithsej 99 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe 14 lëndë të bartura nga viti i kaluar.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** ka pranuar gjithsej 283 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuara.

**Drejtoria për Shërbime Publike:** Ka pranuar gjithsej 156 kërkesa, të shqyrtuara janë 27 kërkesa, ndërsa 129 janë të pashqyrtuara

**Drejtoria për Urbanizëm:** ka pranuar gjithsej 333 kërkesa, të shqyrtuara janë 87 kërkesa, ndërsa 246 janë të pashqyrtuara

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik:** ka pranuar gjithsej 437 kërkesa, të gjitha janë të pashqyrtuara 437.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Gjakovës është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë. Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve.

Lidhur me zbatimin e objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë ndërmarrë mbi njëzet aktivitete dhe projekte në fushat: barazi gjinore, mundësi të barabarta, të drejtat e fëmijëve, kundër dhunës në familje, të drejtat e gruas etj. Disa nga këto aktivitete dhe projekte e zhvilluara: Organizimi i një tryeze me OJQ-të lokale dhe me drejtorët e drejtorisë të kuvendit komunal, me zyrtarët komunal për veprimet që duhen të ndërmerren për uljen e papunësisë tek të rinjtë; tryezë e rrumbullakët mbi dhunën në familje; avokim në përkrahje të shoqatave me PAK në drejtorinë e shëndetësisë për mbështetje financiare të shpenzimeve operative; në bashkëpunim me OSBE-në është realizuar takimi për zbatimin e projektit “Fëmijët që lypin dhe kërkojnë lëmoshë”. Aktivitete të tjera janë: shfaqja e filmit dokumentar mbi të drejtat e gruas mbi trashëgiminë, takime me OJQ-të lokale me qëllim të identifikimit të problemeve të gruas si dhe përparimit të gruas në jetën shoqërore; me kërkesën e ZBGJ drejtuar

Drejtoria e Agrokulturës, është dhënë subvencioni nga Drejtoria e Agrokulturës për përkrahjen e të mbjellave pranverore me ç'rast kanë përfituar 25 gra kryefamiljare; me rastin e 1 qershorit është mbajtur aktiviteti "Fëmijët në skenë" dhe në bashkëpunim me OSBE-në ka filluar zbatimin e projektit "Fëmijët që lypin dhe fëmijët që punojnë" etj.

Për promovimin e të drejtave të minoriteteve janë ndërmarrë masa për regjistrimin e fëmijëve në klasat e para, këshillim dhe adresim i palëve në kërkim të drejtave të tyre, janë ndihmuar të kthyerit nga diaspora dhe regjioni.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në komunën e Gjakovës zbatohet në tërësi. Të gjitha kërkesat nga anëtarët e komuniteteve që janë drejtuar zyrtarit për përkthim janë kryer me kohë. Komuna e Gjakovës ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve. Komuna e ka zyrtarin për përkthim, i cili i plotëson nevojat për përkthim. Komuna siguron transportin për të gjitha komunitetet. NJDNJK merr pjesë pjesërisht në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga KK. NJDNJK bashkëpunon me të gjitha strukturat e nivelit komunal, zyrtarët e organizatave ndërkombëtare, OJQ -të vendore si edhe ato ndërkombëtare, shërbimin policor, gjykatat, qendrën për punë sociale, entin për punësim dhe KFOR-in. NJDNJK ka publikuar aktivitetet e veta nëpërmes fletëpalosjeve.

**Financat lokale.** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Gjakovës është 12,244,283.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 6,743,094.80 ose 55%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 1,622,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 1,036,330.25 ose 63.89%.



## KOMUNA E GJILANIT

**Informacion i përgjithshëm.** Komuna e Gjilanit, përbëhet prej 63 fshatrave me qendër në Gjilan, me një sipërfaqe prej 515 km/2. Popullsia në këtë Komunë sillet rreth 174.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është njëmbëdhjetë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 216.

**Funksionimi i Kuvendit të Komunës.** Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe dy mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar katër mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjashtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Gjilanit ka ngritur pesë komitete konsultative, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, neni 73,1.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Gjilanit ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren komunale për gjuhët, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur dy kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Gjithashtu ka pasur dhe kërkesa e peticione nga qytetarët e Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Gjilanit ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Komuna e Gjilanit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

**Efikasiteti i organeve administrative.** Komuna e Gjilanit ka dërguar raportin për 11 drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 5750



kërkesa, prej të cilave 4307 ose 74,9 % prej tyre janë shqyrtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

**Drejtoria e administratës:** ka pasur gjithsej 995 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 840 kërkesa.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pasur gjithsej 740 kërkesa, prej të cilave 470 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pasur gjithsej 399 kërkesa, prej të cilave 183 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria e Arsimit:** ka pasur gjithsej 75 kërkesa, prej të cilave 1 kërkesë është shqyrtuar.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** ka pasur gjithsej 247 kërkesa, prej të cilave 124 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:** ka pasur gjithsej 65 kërkesa, prej të cilave 23 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari:** ka pasur gjithsej 45 kërkesa, prej të cilave 15 prej tyre janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shërbime Publike:** ka pasur gjithsej 394 kërkesa, prej të cilave 323 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim:** ka pasur gjithsej 17 kërkesa, prej të cilave 4 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë e Banim:** ka pasur gjithsej 2412 kërkesa, prej të cilave 2036 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria e Inspekcionit:** ka pasur gjithsej 361 kërkesa, prej të cilave 288 kërkesa janë të shqyrtuara.

***Të drejtat e njeriut.*** Në Komunën e Gjilanit është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut me tre zyrtarë, të cilët angazhimet në njësit nuk i kanë detyra shtesë. Njësitit nuk ka linjë të veçantë buxhetore, mirëpo aktivitetet financohen varësisht nga mundësitë buxhetore që ka komuna.

Lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë realizuar 2 projekte: projekti "Gruaja dhe trashëgimia" dhe "Stop dhuna". Po ashtu është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Komunës dhe institucioneve që janë të përfshira në mbrojtjen, strehimin dhe përkrahjen e viktimave të dhunës.

Gjithashtu, janë realizuar edhe dy projekte në fushën e barazisë gjinore. Në kuadër të të drejtave të fëmijëve, prioritet i është dhënë mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga keqpërdorimi i punëdhënësve.

Edhe në këtë komunë dukuria e braktisjes së shkollimit është prezente.

Sa i përket aktiviteteve për promovimin e të drejtave të minoriteteve, janë bërë vizita në fshatrat të komunitetit serb.

Ligji për përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve. Komuna ka njësi të përkthimit, i cili i plotëson nevojat për përkthim.

Komuna siguron transportin për të gjitha komunitetet. NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal, si dhe monitoron zbatimin e tyre lidhur me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Gjilanit është 13,694,278.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 6,813,888.15 ose 50%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 2,200,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 1,046,616.48 ose 47.57%.

## KOMUNA E HANIT TË ELEZIT

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Hanit të Elezit përbëhet prej 12 fshatrave me qendër në Hanin e Elezit, me një sipërfaqe prej 83 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 11.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është gjashtë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 55.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dy mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Hanit të Elezit nuk ka ngritur komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Hanit të Elezit ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake. Komuna nuk ka Rregullore komunale për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, apo kërkesa e peticione nga qytetarët e Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës nuk ka raportuar para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Hanit të Elezit nuk ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Komuna ka formuar Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Hanit të Elezit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Hanit të Elezit ka dërguar raportin për pesë (5) drejtori, një drejtori është e porsaformuar andaj nuk ka pranuar asnjë kërkesë ende. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori

është 535, prej të cilave 411 ose 76.82% prej tyre janë shqyrtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 65 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për ekonomi, Financa dhe bujqësi:** janë pranuar gjithsej 295 kërkesa, të shqyrtuara 180 kërkesa, ndërsa ende të pa shqyrtuara janë 115 kërkesa.

**Drejtoria e urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 36 kërkesa, të shqyrtuara 30 kërkesa, ndërsa 6 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 104 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 35 kërkesa, të shqyrtuara janë 32 kërkesa, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

**Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë:** nuk ka pranuar dhe shqyrtuar ndonjë kërkesë.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Hanit të Elezit është themeluar Njësia për të Drejtat e Njeriut. Trajnimi i Njesisë për këtë komunë, do të fillojë në muajin shtator 2009 (projekt që mbështetet nga MAPL). Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve. NJDNJK ka tre anëtarë, koordinatori dhe anëtarët e tjerë, të cilët punojnë me detyra shtesë. Nuk ka një linjë të veçantë ë buxhetore për njësitin.

Në mungesë të mjeteve buxhetore, njësitin nuk ka mundur të zhvillojë aktivitete dhe projekte, përveç shënimit të 8 Marsit dhe 1 Qershorit (Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve)

Ligji për Barazi Gjinore zbatohet në këtë komunë dhe në drejtim të zbatimit të këtij ligji dhe ofrimit të mundësive të barabarta, njësitin merr pjesë në panele intervistuese. Nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Ligji për të Drejtat e komuniteteve zbatohet në tërësi. Përveç gjuhëve zyrtare, nuk ka gjuhë tjetër në përdorim zyrtar. Në këtë Komunë nuk ka njësi të përkthimit.

NJDNJK merr pjesë rregullisht në hartimin e politikave, rregulloreve të nxjerra nga KK, si dhe monitoron zbatimin e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Hanit të Elezit është 1,153,143.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 428,492.02 ose 37%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 73,400.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 70,434.86 ose 95.96%.

## KOMUNA E ISTOGUT

**Informacion i përgjithshëm.** Komuna e Istogut ka një sipërfaqe prej 454 km<sup>2</sup>. Kjo komunë ka një popullsi prej rreth 56.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është tetë, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 123.

**Funksionimi i Kuvendit të Komunës.** Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Istogut ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe katër mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Istogut nuk ka ngritur komitete konsultative. Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Istogut nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren komunale për gjuhët, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 gjithashtu ka pasur rast të paraqitjes së konfliktit të interesit nga kryetari i Komunës, si edhe nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Istogut ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Komuna e Istogut ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Komuna ka lidhur marrëveshje të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e zhvillimit ekonomik. Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

**Efikasiteti i organeve administrative.** Për gjashtëmujorin e parë në vitin 2009, komuna e Istogut ka dërguar raportin për tetë (8) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave, në këto drejtori është 1594 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 1491 ose 93.5%.

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 311 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 311 kërkesa.

**Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 143 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 143 kërkesa.

**Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 713 kërkesa. Prej tyre 651 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** nuk ka pranuar kërkesa.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 163 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar 143 kërkesa. Prej tyre 199 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Bujqësi:** janë pranuar 38 kërkesa. Prej tyre 29 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për inspektorat:** janë pranuar 83 kërkesa. Prej tyre 75 janë shqyrtuar.

**Të drejtat e njeriut.** Në Komunën e Istogut është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë. Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve. Lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, njësi ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme: është hapur biblioteka ligjore në komunë; janë bërë fushata lidhur me parandalimin e dukurive negative që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve; është bërë përcjellja e provimit të maturës dhe semimaturës; është shënuar 1 Qershori (Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve); janë bërë aktivitete me fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat e specializuara dhe janë shpërndarë dhurata; janë realizuar debate me nxënës, prindër, arsimtarë, si dhe shumë aktivitete të tjera. Në komunë janë realizuar mbi 10 aktivitete dhe 5 projekte në fusha të ndryshme, si: barazi gjinore, mundësi të barabarta, të drejtat e fëmijëve, kundër dhunës në familje, kundër dukurive negative që dëmtojnë shëndetin, sigurinë në shkollë, parandalimin e përdorimit të armëve gjatë festave, parandalimit të plaçkitjes me maska etj. NDNJK mban kontakte të vazhdueshme me HENDIKOS-in me qëllim të promovimit të mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Është nxjerrë rregullorja për përdorimin e gjuhëve. Në komunë ekziston njësi i përkthimit, i cili i plotëson të gjitha nevojat për përkthim. Me qëllim të lehtësimit dhe integritit të komuniteteve në shoqëri, komuna siguron transport për të gjitha komunitetet. NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës. NJDNJK bashkëpunon me strukturat e nivelit qendror, nivelit lokal, organizatat joqeveritare dhe organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.

**Financat lokale.** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Istogut është 5,038,352.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 1,781,806.09 ose 35%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 578,500.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 345,337.13 ose 59.70%.

## KOMUNA E JUNIKUT

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Junikut, ka një sipërfaqe prej 77.7 km/2. Popullsia, në këtë komunë është rreth 96000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është gjashtë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 53.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dy mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Junikut nuk ka ngritur komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Junikut ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative. Rregullorja komunale për gjuhët është në fazën e shqyrtimit.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, gjithashtu ka pasur rast të paraqitjes së konfliktit të interesit nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës nuk ka raportuar para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Junikut nuk ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike. Ndërkohë, pranë komunës funksionon arkivi dhe zyra pritëse.

Komuna e Junikut, ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale.

Komuna ka lidhur marrëveshje me fshatra, vendbanimet apo lagjet brenda territorit të saj, në përputhje me nenin 34,1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi i Komunës së Junikut ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.



*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Junikut ka dërguar raportin për gjashtë(6) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 582 kërkesa, prej të cilave 543 ose 93.29 % prej tyre janë shqyrtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 356 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa:** janë pranuar gjithsej 92 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis:** janë pranuar gjithsej 42 kërkesa dhe janë shqyrtuar të gjitha.

**Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport:** janë pranuar gjithsej 67 kërkesa, të shqyrtuara 63 kërkesa.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 19 kërkesa, të shqyrtuara janë 18, e pashqyrtuar 1 lëndë

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektion:** janë pranuar gjithsej 16 kërkesa, të shqyrtuara janë 6, të pashqyrtuara ende janë 10 lëndë.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Junikut është themeluar Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë. Zyrtarët do të certifikohen me rastin e mbajtjes së moduleve të trajnimit, që mbështeten nga MAPL, trajnime të cilat do të fillojnë në muajin shtator të vitit 2009.

Kjo Njësi nuk ka linjë të veçantë buxhetore, por aktivitetet e saj financohen përmes projekteve që financohen nga Kuvendi i Komunës, apo donatorë të ndryshëm.

Njësia për të drejtat e njeriut ka marrë pjesë, si dhe ka organizuar vetë aktivitete që synojnë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kryesisht në fushat e barazisë dhe integritetit gjinor, mundësive të barabarta, të drejtave të fëmijëve dhe kundër diskriminimit.

Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve. Po ashtu, është monitoruar në vazhdimësi zbatimi i udhëzimit të MAPL për aplikimin e gjuhëve në përdorim zyrtar.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Junikut është 874,276.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 319,693.23 ose 37%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 35,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 21,101.83 ose 60.29%.



## KOMUNA E KAÇANIKUT

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Kaçanikut, ka një sipërfaqe prej 306 km/2 dhe popullsia prej rreth 33.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është shtatë, ndërsa numri i stafit të lejuar i administratës komunale është 94.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar katër mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe një mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Kaçanikut nuk ka krijuar komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Kaçanikut ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake. Komuna nuk ka Rregullore për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare apo kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, apo nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Kaçanikut ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike

Komuna e Kaçanikut ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut nuk e ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

Efikasiteti i organeve administrative. Komuna e Kaçanikut ka dërguar raportin për shtatë (7) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 1744 kërkesa, prej të cilave 1659 kërkesa ose 95.12% prej tyre janë shqyrtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 234 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 338 kërkesa, të shqyrtuara 236 kërkesa, ndërsa 2 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

**Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 634 kërkesa, të shqyrtuara janë 557 kërkesa, ndërsa 77 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 27 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 369 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:** janë pranuar 28 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara janë 25 kërkesa, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar 114 kërkesa, prej tyre të shqyrtuara 111 kërkesa, ndërsa 3 kërkesa nuk janë shqyrtuar ende.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Kaçanikut është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut me tre zyrtarë.

Kjo Njësi nuk ka linjë të veçantë buxhetore, por aktivitetet e saj financohen përmes projekteve që financohen nga Kuvendi i Komunës, apo donatorë të ndryshëm.

Njësia për të drejtat e njeriut ka ndërmarrë aktivitete si dhe projekte të ndryshme me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga Strategjiti dhe Planet e Veprimeve për të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim mund të përmenden: Mbatja e sesionve në lidhje me barazinë gjinore me OJQ-në CDI dhe QMFK (qendra e mjeksisë familjare). Gjithashtu janë realizuar 18 projekte gjatë muajit maj - qershor, aktivitete të cilat kanë pas të bëjnë me sensibilizimin e komunitetit lidhur me barazinë gjinore, mundësi të barabarta, të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara, ndalimin e diskriminimit etj.

Sa i përket ofrimit të mudnësive të barabarta për të gjithë janë ndërmarrë kampanja vetëdijësuese gjatë muajit maj – qershor, pashtu njësi ka udhezuar dy persona me aftësi të kufizuara për përfitimin e pensionit invalidor, ka kërkuar nga organizata joqeveritare “Shtëpia e Shpresës” në ofrimin falas të kursit për kompjuter për PAK.

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve është shënuar 1 qershori – Dita Ndërkombëtare për të Drejtave të Fëmijëve, poashtu është organizuar një takim me kryetarin e komunës dhe një grup nxënësish, për të diskutuar lidhur me krijimin e kushteve për mësim nëpër shkolla, ruajtjen e ambientit, ndalimin e huliganizmit nëpër shkolla etj.

Komuna nuk ka njësit për përkthim ngase nuk ka komunitete tjera përveç komunitetit shqiptarë.

Njësit bashkëpunon me drejtoritë komunale, zyrën ligjore si dhe me OSBE-në, mirëpo nuk merr pjesë në hartimin e e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal.

**Financat lokale.** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Kaçanikut është 3,640,359.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 1,586,762.50 ose 44%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 258,250.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 196,399.76 ose 76.05%.

## KOMUNA E KAMENICËS

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Kamenicës, ka një sipërfaqe prej 523 km/2 dhe popullsi prej rreth 53.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është gjashtë, ndërsa numri i stafit të administratës komunale është 155.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe dy mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pesë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Kamenicës ka ngritur komitete konsultative. Gjithashtu, Kuvendi i Komunës ka ngritur edhe shtatë komitete të tjera, të konsideruara të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tij.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Kamenicës ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative, Rregulloren për gjuhët. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur dy kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Nuk ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ndërkohë që nuk ka pasur raste të paraqitjes së konfliktit të interesit nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Kamenicës ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Komuna e Kamenicës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane brenda territorit të saj.

Komuna e Kamenicës ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Kamenicës ka dërguar raportin për 6 drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 3987 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara janë 3835 kërkesa ose 96,18 % prej tyre. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

**Drejtoria e Administratës:** Ka pranuar gjithsej 2717 kërkesa, prej tyre 2717 kërkesa të shqyrtuara.

**Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Ka pranuar gjithsej 485 kërkesa, prej tyre 474 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pranuar gjithsej 406 kërkesa, prej të cilave 356 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Arsime dhe Kulturë:** Ka pasur gjithsej 69 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** ka pasur gjithsej 271 kërkesa, prej të cilave 189 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** ka pasur gjithsej 3987 kërkesa, prej të cilave 3835 kërkesa janë shqyrtuar.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Kamenicës është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë, të certifikuar për vijimin e 20 moduleve të trajnimit, ku përfshihen të gjitha fushat e të drejtave të njeriut.

Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve. Në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, NJDNJK ka ndërmarrë aktivitete dhe projekte të ndryshme. Vlen të përmendet: Shënimi i 1 Qershorit (Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve), ku kanë përfituar fëmijët të cilët janë shpërblyer me dhurata si dhe është organizuar një program kulturor-artistik.

Sa i përket të drejtave të fëmijëve, ka pasur 6 raste të intervenimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

NJDNJK ka pranuar 4 kërkesa nga qytetarë lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe atyre u ka ofruar këshilla lidhje me adresimin e kërkesave të tyre.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Kamenicës është 5,802,394.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 2,475,575.83 ose 43%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 440,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 266,209.01 ose 60.50%.

## KOMUNA E KLINËS

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Klinës përbëhet prej 54 vendbanimesh me qendër qytetin e Klinës, me një sipërfaqe prej 309 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 60.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është shtatë, ndërsa numri i stafit të administratës komunale është 120.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Klinës ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe dy mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjashtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Klinës nuk ka ngritur komitete konsultative. Ndërkohë, Kuvendi i Komunës ka ngritur edhe katër komitete të tjera, të konsideruara të nevojshme për kryerjen e përgjegjësiave të tij.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Klinës nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për gjuhët. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake. Nuk është miratuar ende Rregullorja për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative,

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë, ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët drejtuar Kuvendit të Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Klinës ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Klinës nuk ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

Efikasiteti i organeve administrative. Për vitin 2009, komuna e Klinës ka dërguar raportin për shtatë (7) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave, në këto drejtori është 3510 prej të cilave janë shqyrtuar 3438 ose 97.9% prej tyre. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 908 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 908 kërkesa.

**Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 1133 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.

**Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 670 kërkesa. Prej tyre 625 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 211 kërkesa, të shqyrtuara të gjitha.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 195 kërkesa. Prej tyre 190 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar 332 kërkesa. Prej tyre 310 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Inspektorat:** janë pranuar gjithsej 61 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

*Të drejtat e njeriut.* Në Komunën e Klinës është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë, të certifikuar për vijimin e 20 moduleve të trajnimit, ku përfshihen të gjitha fushat e të drejtave të njeriut.

Kjo Njësi ka emëruar edhe zyrtarin për të drejtat e komuniteteve.

Zyrtarët e njësitit janë të angazhuar me detyra shtesë, me përjashtim të zyrtarit për të Drejtat e Fëmijëve.

Komuna ka ndarë mjete të veçanta financiare për aktivitetet e njësitit. Në bashkëpunim me OJQ-të vendore, janë realizuar 6 projekte dhe aktivitete si: trajnimi me temën “Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje”, si dhe “Statusi social i grave”; Trajnimi për të drejtat e grave si dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi; Seminari me temën “Përmirësimi të drejtave të grave, të rinjve dhe minoriteteve në rajon”.

Janë mbajtur debate në radiot lokale për Barazinë Gjinore, për pozitën e gruas në institucionet lokale dhe në ato qendrore; me datë 9 maj, me rastin e Ditës së Evropës, janë organizuar aktivitete sportive me vajza. Është e rëndësishme të përmendet edhe ndarja e nëntë bursave për vajza të shkollës së mesme, me kërkesën e NJDNJK-së ndaj “Rotary Klubit” në Pejë, e cila iu ndihmon vajzave me sukses të shkëlqyeshëm dhe me gjendje të varfër ekonomike.

Me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë, NJDNJK merr pjesë në të gjitha panelet intervistuese si anëtar i panelit e jo si vëzhgues.

Për çdo muaj mbahet Asambleja e Fëmijëve, ku diskutohen të gjitha problemet e fëmijëve nëpër shkolla dhe në jetën e përditshme. Ligji për të drejtat e komuniteteve zbatohet në tërësi.

Janë realizuar projekte të ndryshme lidhur me krijimin e kushteve për kthim, lehtësim në punësim, si dhe lëmi të tjera.

Në tërësi ligji për përdorim të gjuhëve zbatohet. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve dhe ka njësitin e përkthimit që i plotëson të gjitha nevojat .

Komuna siguron transportin për të gjitha minoritetet. Njësiti merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal si dhe monitoron zbatimin e tyre

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Klinës është 4,996,631.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 2,348,699.66 ose 47%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 685,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 548,165.15 ose 80.02%.



## **Komuna e Leposaviqit**

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë përbëhet prej 72 fshatrave me qendër në Leposaviq, me një sipërfaqe prej 750 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 19.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 17 anëtarë. Numri i drejtorive është pesë, ndërsa, numri i stafit të administratës komunale është 103.

### *Funksionimi i Kuvendit të Komunës.*

Nuk ka informacion.

### *Efikasiteti i organeve administrative*

Nuk ka informacion.

## KOMUNA E LIPJANIT

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Lipjanit, ka një sipërfaqe prej 422 km/2. Popullsia në këtë komunë sillet rreth 75.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është nëntë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 162.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe asnjë mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar shtatë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dy mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Lipjanit nuk ka ngritur komitete konsultative. Ndërkohë, Kuvendi i Komunës ka ngritur edhe katër komitete të tjera, të konsideruara të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tij. Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Lipjanit ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative, Rregulloren për gjuhët. Po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, mirëpo ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ndërkohë që ka pasur raste të paraqitjes së konfliktit të interesit nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Komuna e Lipjanit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane brenda territorit të saj. Komuna e Lipjanit ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Lipjanit nuk ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Lipjanit ka dërguar raportin për nëntë (9) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 4242 kërkesa, prej të cilave 3253 ose 76.68%, janë trajtuar. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 547 kërkesa, të shqyrtuara janë 539 kërkesa, të pashqyrtuara janë 8.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 922 kërkesa, të shqyrtuara janë 553, të pashqyrtuar 369.

**Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 1456 kërkesa, të shqyrtuara 1036 kërkesa, të pashqyrtuara 420.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 68 kërkesa, të shqyrtuara 66, të pashqyrtuara 2 kërkesa.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 269 kërkesa, 228 janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara janë 41.

**Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari:** ka pranuar gjithsej 12 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

**Drejtoria e Inspektionit** - ka pasur gjithsej 207 kërkesa, të shqyrtuara janë 193, të pashqyrtuara janë 14.

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** ka pasur gjithsej 212 kërkesa, prej tyre 194 kërkesa janë shqyrtuara, të pashqyrtuar janë 18.

**Drejtoria e Prokurimit:** ka pasur gjithsej 65 kërkesa, janë shqyrtuar 47.

**Të drejtat e njeriut.** Në Komunën e Lipjanit është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë, të certifikuar për vijimin e 20 moduleve të trajnimit, ku përfshihen të gjitha fushat e të drejtave të njeriut.

Me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut, NJDNJK ka realizuar projekte dhe aktivitete të ndryshme në fushat: barazi gjinore, kundër dhunës në familje, të drejtat e fëmijëve etj. Të tilla mund të përmenden: Projekti “Dhuna në familje”, i cili është mbështetur nga OSBE-ja në bashkëpunim me komunën; fushatat ndërgjegjësuese për njohjen e të drejtave të njeriut; Dialog ndëretnik në fshatin Kraishtë; Takimi me deputete me datë 12 qershor, tema “Femra në vendimmarrje”, financuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës etj.

Aktivitete të tjera janë bërë në lidhje me të drejtat e fëmijëve si: aktiviteti për të drejtat e fëmijëve i mbajtur maj - qershor, përfitues 100 fëmijë; takimi me kryetarin e komunës me rastin e Ditës së Fëmijëve 1 Qershori, financuar nga Kuvendi i Komunës; kampi fushor në “Blinajë”; gara futbollit të sallës, financuar nga Kuvendi i Komunës me nxënësit e shkollave fillore.

Sipas të dhënave që MAPL ka në dispozicion, në këtë komunë ka pasur raste të braktisjes së mësimin, por me angazhimin e NJDNJK-së, ka pasur raste që fëmijët janë kthyer në shkollë dhe vazhdojnë mësimin normalisht.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Të gjitha aktet komunale përkthehen në gjuhët zyrtare. Të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në administratën komunale.

Komuna siguron transport për të gjitha minoritetet.

NJDNJK pjesërisht merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal. Është hartuar plani i veprimit

për të drejtat e njeriut së bashku me koston financiare. Vështirësitë me të cilat përballet NJDNJK lidhen me mungesën e buxhetit dhe me mosbashkëpunimin sa duhet me organet komunale.

*Financat lokale.* Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Lipjanit është 7,850,225.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 3,492,932.94 ose 44%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 730,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 622,437.54 ose 85.27%.

## Komuna e Malishevës

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 306.3 km<sup>2</sup>. Komuna e Malishevës ka mbi 65,000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 31 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Kuvendi i Komunës, numëron gjithsej 8 drejtori. Ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 129.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. – gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Malishevës ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar normalisht dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej pesë mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur tre mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar edhe komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Por ka themeluar dy komitete të tjera, të cilat kanë qene të domosdoshme dhe i janë përshtatur specifikave të vetë komunës.

Kuvendi i Komunës, ka mbajtur tubime publike me qytetarë dhe ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit.

Komuna e Malishevës ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, por ende nuk ka të miratuar rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregullore për transparencën komunale.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Malishevës për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, apo ndonjë kërkesë dhe petition. Gjithashtu nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, por rasti i deklarimit të konfliktit të interesit është bërë në raste të caktuara nga kryetari i komunës.

Komuna e Malishevës ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, por gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Malishevës gjithashtu është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin. Është me rëndësi të përmendet së në këtë gjashtëmujor, Komuna e Malishevës ka hartuar Strategjinë dhe Planin, për

zhvillimin social dhe ekonomik lokal. Gjithashtu është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Komuna e Malishevës, ka tetë drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave, në këto drejtori është 3049 kërkesa prej të cilave, (duke u bazuar në të dhënat e paraqitura nga zyrtarët komunal), të gjitha janë shqyrtuar.

Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

- Drejtorja për Administratë dhe Personel: janë pranuar 2316 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 2316 kërkesa;
- Drejtorja për Financa dhe Ekonomi dhe Zhvillim: janë pranuar gjithsej 96 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 96 kërkesa;
- Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit: janë pranuar 247 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara;
- Drejtorja për Arsim dhe Kulturë: janë pranuar 86 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara;
- Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: janë pranuar 100 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara;
- Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi dhe inspektorat: janë pranuar 87 kërkesa, prej tyre 86 janë shqyrtuar;
- Drejtorja për Emergjencë dhe Shërbime Publike: janë pranuar gjithsej 105 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
- Drejtorja për Rini dhe Sport: janë pranuar gjithsej 12 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Malishevës është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësi ka tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komunë. Njësi nuk ka linjë të veçantë buxhetore.

Me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut janë realizuar disa takime në fushat: barazi gjinore dhe të drejtat e fëmijëve. Janë marrë masa vetëdijesimi, si: Vetëdijesimi i fëmijëve (për sëmundjet ngjitëse, në veçanti për ethet hemorragjike). Ligji për Barazi Gjinore zbatohet në masë të duhur. Janë mbajtur disa takime për arritjen e barazisë gjinore. Njësi bashkëpunon dhe përkrah realizimin e aktiviteteve të PAK. Përfaqësues të njësitit kanë marrë pjesë në tri panele intervistuese (në njërën si kryesues, dhe në dy tjerat si anëtar).

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Rregullorja për përdorimin e gjuhëve është në procedurën e hartimit. NJDNJK nuk merr pjesë rregullisht në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal dhe monitoron pjesërisht zbatimin e tyre.

NJDNJK bashkëpunon me strukturat e nivelit komunal dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare.

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Malishevës, për vitin 2009, është: **6,517,876.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Malishevës, kishte planifikuar të hyra në vlerë 669,250.00 . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 220,587.64, përkatësisht 32.96%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën 141,139.26 €.

## **Komuna e Mamushës**

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë ka një territor prej 12,4 km/2 dhe një numër prej rreth 5 000 banorësh, me shumicë popullsie të komunitetit turk. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 15 anëtarë. Numri i drejtorive është katër. Numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 16.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* – gjatë periudhës janar - qershor 2009, Kuvendi i komunës së Mamushës ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar normalisht dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 1 mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale, por është themeluar një komitet tjetër, i cili është krijuar duke ju përshtatur specifikave të vetë komunës.

Kuvendi i Komunës, ka mbajtur tubime publike me qytetarë dhe ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Mamushës ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake. Gjithashtu, ka miratuar edhe rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregulloren për transparencën komunale.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Mamushës për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, apo ndonjë kërkesë për peticion. Ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit edhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, edhe nga ana e kryetarit të komunës.

Komuna e Mamushës ka lidhur Marrëveshje binjakëzimi me Komunën Sahlili të Republikës së Turqisë, ndërsa nuk ka pasur ndonjë marrëveshje të lidhur me me fshatra, vendbanime apo lagje. Në komunën e Mamushës gjithashtu është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Mamushës ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal. Gjithashtu kuvendi i Komunës ka miratuar edhe Listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i organeve të administratës.*- Komuna e Mamushës, ka katër drejtori. Për periudhën e raportimit, drejtoritë përkatëse kanë pranuar gjithsej 366 kërkesa prej të cilave janë shqyrtuar 359 ose 98% prej tyre.



Numri konkret i kërkesave të parashtruara dhe të trajtuara nëpër drejtoritë përkatëse, është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** ka pranuar gjithsej 82 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pasur gjithsej 264 kërkesa, prej tyre 258 të shqyrtuar.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pasur gjithsej 20 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Arsim dhe Shëndetësi:** nuk ka pasur asnjë kërkesë të parashtruar.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Mamushës në këtë gjashtëmujor është themeluar njësi për të drejtat e njeriut. Njësi ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komunë. Zyrtarët e këtij njësi do të jenë pjesëmarrës në programin për ngritjen e kapaciteteve profesionale të organizuar nga MAPL, dhe do të certifikohen pasi të përfundojnë modulet e trajnimit.

Njësi ka qenë aktive dhe pjesëmarrëse në organizime të ndryshme, konferenca dhe tryeza në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

NJDNJK monitorojnë zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Deri tani nuk ka pasur asnjë ankesë nga zyrtarët komunal apo nga qytetarët, sa i përket mos realizimit të ndonjë kërkesë për përkthim apo qasje në shërbime në gjuhën e tyre. Problemet janë paraqitur kryesisht kur zyrtarët e të drejtave të njeriut janë obliguar të kryejnë edhe punë të tjera shtesë, në kuadër të Komunës.

**Financat lokale.** Buxheti i aprovuar i Komunës së Mamushës, për vitin 2009, është: **723,311.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Mamushës, kishte planifikuar të hyra në vlerë 61440.00 €. Për gjashtëmujorin e parë Komuna ka realizuar 9885.56, 00 €, përkatësisht 16.9%.

Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **306,198.27 €**.

## **Komuna e Mitrovicës**

*Informacion i përgjithshëm.* Komuna e Mitrovicës ka 49 fshatra, me qendër në Mitrovicë me një sipërfaqe prej 350km/2. Popullsia në këtë Komunë është rreth 110.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 41 anëtarë. Numri i drejtorive është dhjetë, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 200.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka mbajtur katër mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtë zakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe tre mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Kuvendi i Komunës ende nuk ka themeluar Komitete Konsultative, në përputhje me nenin 73.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ndërkohë që janë ngritur gjashtë komitete të tjera në përputhje me nenin 51,2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës nuk ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregullorja e punës së Kuvendit, Rregullorja për punën e Komiteteve, Rregullorja për gjuhët, ndërkohë që nuk është miratuar Rregullorja për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur 20 kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare. Ndërkohë, që është pranuar një petition nga qytetarët e Komunës në lidhje me shpalljen e interesit të përgjithshëm.

Në përputhje me nenin 38.2 dhe 59.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit, si nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e kryetarit. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës. Komuna e Mitrovicës ka miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Mitrovicës ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

*Efikasiteti i organeve administrative.* Numri i përgjithshëm i kërkesave në organet administrative të Komunës së Mitrovicës për gjashtëmujorin e parë është 3915 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuara 904 ose 23.09.% prej tyre. Ndërkohë që pjesa tjetër e kërkesave është ende në shqyrtim. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** ka pranuar gjithsej 655 kërkesa, të shqyrtuara 245, në shqyrtim 410.

**Drejtoria e Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** ka pranuar gjithsej 490 kërkesa, kurse të shqyrtuara kemi 480 kërkesa, të pa shqyrtuara ende janë 10 lëndë.

**Drejtoria për Arsim:** ka pranuar gjithsej 220 kërkesa, të shqyrtuara 10, në shqyrtim 210.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte:** ka pranuar gjithsej 90 kërkesa, të shqyrtuara 51, në shqyrtim 39.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pranuar gjithsej 1368 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara kemi 311 kërkesa të pashqyrtuara ende janë 1057 lëndë.

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim:** ka pranuar gjithsej 26 kërkesa, të gjitha në shqyrtim e sipër.

**Drejtoria për Shërbime Publike dhe infrastrukturë:** ka pranuar gjithsej 221 kërkesa, të shqyrtuara 56, në shqyrtim 165 kërkesa.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale:** ka pranuar gjithsej 225 kërkesa, të shqyrtuara 161, në shqyrtim 64 kërkesa.

**Drejtoria për Bujqësi:** ka pranuar 61 kërkesa, të gjitha në shqyrtim.

**Drejtoria e Inspektoriatit:** ka pranuar gjithsej 559 lëndë, të shqyrtuara kemi 60, ende në shqyrtim 449 kërkesa.

### *Të drejtat e njeriut.*

Në komunën e Mitrovicës është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kritereve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësia ka 3 anëtarë të cilët detyrat i kryejnë si punë shtesë.

Me qëllim të zbatimit të objektivave që dalin nga strategjitë dhe planet e veprimeve për të drejtat e njeriut njësi ka realizuar projekte, aktivitete, konferenca, tryeza, manifestime etj. Janë realizuar mbi 15 projekte dhe aktivitete në fushat: barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e komuniteteve, mundësi të baraarta për PAK, të drejtat e njeriut etj. Disa nga këto projekte dhe aktivitete janë: Formimi dhe funksionalizimi i Komitetit për Barazi Gjinore (kërkesë e NJDNJK-së); Takime të rregullta me përfaqësues ndërkombëtar (ICO, EULEX, OSCE); Bashkëorganizim i aktiviteteve të ndryshme me Zyrën për Integritim Evropian (Plani mbi procesin e Integritimit Evropian në komunën e Mitrovicës, 9 Maji Dita e Europës, Raportim për realizimin e prioriteteve që dalin nga PVPE); partneriteti në projektin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerzore me organizatën AED; Organizimi i takimit për Strategjinë për personat me Aftësi të Kufizuara; tryeza “Siguria njerzore dhe të drejtat e njeriut” – Policia e Kosovës; shënimi i 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve; trajnime për të rinj në fushën e të drejtave të njeriut etj. Ligji për të Drejtat e Komuniteteve zbatohet në tërësi.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Komuna ka një zyrtar për përkthim. Komuna ka nxjerrë Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve në qershor 2009.

Komuna siguron transport për të gjitha komunitetet. Njësi bashkëpunon shumë mirë me drejtoritë komunale, zyrën ligjore dhe poashtu vazhdimisht merr pjesë në hatimin politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal. Përveç organeve komunale NJDNJK bashkëpunon me të gjitha OJQ-të e qytetit, po ashtu me organizata tjera si OSCE, ICO, UNHCR, KAD, UNDP

Vështirësitë që përballet njësi kanë të bëjnë me mungesën e zyreve, mungesën e buxhetit si dhe mosrregullimin e statusit dhe kontratave të stafit të NJDNJK-së.

***Financat lokale.***- Buxheti i aprovuar i Komunës së Mitrovicës, për vitin 2009, është: **11,524,978.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Mitrovicës , kishte planifikuar të hyra në vlerë 1346300.00 € . Për gjatëmuajin e parë Komuna ka realizuar të hyra vetanake në vlerë 593704.91, € përkatësisht 58.67%.

Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **4,965,717.71 €**.

## **Komuna e Novobërdës**

*Informacion i përgjithshëm.* Territori i komunës së Novobërdës ka një sipërfaqe prej 91.6 km<sup>2</sup>. Komuna e Novobërdës ka mbi 3.900 me gjithsej 15 vendbanime. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 17 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Komuna e Novobërdës, ka gjithsej 6 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 67.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* - gjatë periudhës janar - qershor 2009, Kuvendi i komunës së Novobërdës ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 1 mbledhje.

Në këtë komunë nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Kuvendi i Komunës, ka mbajtur tubime publike me qytetarë dhe ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Novobërdës ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregullore për transparencën komunale.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Novobërdës për periudhën e gjashtëmujorit të parë ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe një kërkesë për peticion. Gjithashtu ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit edhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, edhe nga ana e Kryetarit të Komunës.

Komuna e Novobërdës nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Novobërdës gjithashtu është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Edhe në këtë gjashtëmujor, Komuna e Novobërdës nuk ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal, ndërsa, ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i organeve të administratës.*- Komuna e Novobërdës ka gjashtë drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 302, ku prej tyre janë shqyrtuar 301 kërkesa ose 99,9 % .

Më poshtë është paraqitur numri i saktë i kërkesave të parashtruara dhe të trajtuara nga drejtoritë përkatëse:

- **Drejtoria e Administratës:** Ka pranuar gjithsej 46 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
- **Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Ka pranuar gjithsej 15 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
- **Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** ka pranuar gjithsej 183 kërkesa, prej të cilave 182 kërkesa janë shqyrtuar.
- **Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** Ka pasur gjithsej 20 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** ka pasur gjithsej 19 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.
- **Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** ka pasur gjithsej 20 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar.

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Novobërdës është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësi ka dy zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komunë.

Lidhur me zbatimin e objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit, deri më tani nuk është realizuar asnjë projekt për shkak të mungesës së mjeteve. Sa i përket aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut janë organizuar trajnime ("Gruaja dhe trashëgimia në pronë"), vetëdijësimi i nxënësve lidhur me dhunën paramartesore, njoftimi i femrave me punën e administratës komunale.

Aktivitetet e NJDNJK-së për arritjen e barazisë gjinore lidhen me mbajtjen e trajnimeve, fushatave vetëdijësuese, tryezave të rrumbullakëta për mos diskriminimin në baza gjinore. Për këtë periudhë kohore, NJDNJK ka marrë pjesë 3 herë në panele intervistuese.

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, komuna ka ndërhyrë në dy raste: tek fëmijët bonjak që janë lënë në rrugë, si dhe përmes Qendrës për Punë Sociale është siguruar familja për përkujdesjen e foshnjave të porsalindura, deri në moshën e caktuar dhe kohë pas kohe vizitohen nga zyrtarët komunal.

Ligji për të drejtat e komuniteteve zbatohet në tërësi. Është analizuar gjendja e komunitetit rom dhe serb, me të cilët është duke u punuar për përmirësimin e kushteve të banimit.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve kryesisht zbatohet. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin gjuhëve. Komuna ka vetëm një zyrtar për përkthim.

Gjithashtu, komuna siguron transport për të gjitha minoritetet.

NJDNJK nuk merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal si dhe monitoron zbatimin e tyre lidhur me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

NJDNJK ka bashkëpunim me strukturat e nivelit komunal, dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare. Vështirësi kryesore e NJDNJK-së është mungesa e buxhetit.

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Novobërdës, për vitin 2009, është: **1,018,739.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Novobërdës, kishte planifikuar të hyra në vlerë 17 700.00 € . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 6016.99 € përkatësisht 33.99%.Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **260,052.06 €**.



## **Komuna e Obiliqit**

*Informacion i përgjithshëm.* Territori i komunës së Obiliqit është me një sipërfaqe një sipërfaqe prej 105 km<sup>2</sup>, me 19 vendbanime. Komuna e Obiliqit, ka mbi 25.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje pre 21 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Qeveria komunale, numëron gjithsej 7 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 85.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* - gjatë periudhës janar qershor 2009, Kuvendi i komunës së Obiliqit ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 2 mbledhje.

Në këtë komunë, janë themeluar 4 komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale dhe 4 komitete tjera. Kuvendi i Komunës, ka mbajtur tubime publike me qytetarë dhe ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Obiliqit ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare, nuk ka miratuar rregulloren për transparencën komunale.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Obiliqit për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe kërkesë për peticion. Ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, derisa kjo ka ndodhur edhe në rastin e kryetarit të komunës.

Komuna e Obiliqit nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunitet tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Obiliqit gjithashtu është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Obiliqit ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal dhe ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.*- Komuna e Obiliqit ka gjashtë drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 1226 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara janë 1120 ose 91.35%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:



**Drejtoria për Administratë:** janë pranuar gjithsej 389 kërkesa, prej tyre 374 janë

të shqyrtuara, të pashqyrtuar mbeten 15.

**Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 278 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 459 kërkesa. Prej tyre të shqyrtuara 368 kërkesa, të pashqyrtuara janë 91.

**Drejtoria Arsim, Kulturë dhe Sport:** janë pranuar gjithsej 64 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 14 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** ka pasur gjithsej 22 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Obiliqit është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. NJDNJK ka 3 anëtarë me detyra shtesë.

Aktivitetet e njësitit nuk janë mbështetur financiarisht nga komuna, por nga donatorët e tjerë. Ka munguar prezenca e anëtarëve të NJDNJK-së në panele intervistuese.

Ligji për të Drejtat e Komuniteteve zbatohet në tërësi. Janë mbajtur takime të ndryshme me komunitetet, grupet lokale për kthim, ndërsa, nuk është evidentuar ndonjë rast të shkeljes së të drejtave të minoriteteve

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet plotësisht, është miratuar edhe Rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë. Nuk ka njësi të përkthimit. Është vetëm një përkthyes serbisht-shqip dhe anasjelltas.

Komuna siguron transport për të gjitha komunitetet.

NJDNJK merr pjesë në hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës. Sa i përket vështirësive që paraqiten, ato kanë të bëjnë me punën shtesë e cila iu ngarkohet zyrtarëve dhe mungesa e një linje buxhetore për NJDNJK-në.

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Obiliqit, për vitin 2009, është: **3,135,493.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Obiliqit, kishte planifikuar të hyra në vlerë 430 000, 00 € . Për gjashtëmujorin e parë Komuna ka realizuar 187 904.33 € përkatësisht 43.70%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **1,354,688.58 €**.

## Komuna e Pejës

**Informacion i përgjithshëm.** Territori i komunës së Pejës është me një sipërfaqe prej rreth 603km<sup>2</sup>. Komuna e Pejës, ka mbi 170.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 41 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Komuna e Pejës ka gjithsej 9 drejtori, ndërsa numri i stafit të administratës së Komunës është 266.

**Funksionimi i Kuvendit të Komunës.** – gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Pejës ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 6 mbledhje.

Në këtë komunë, janë themeluar 4 komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale dhe 4 komitete tjera. Kuvendi i Komunës, s'ka mbajtur tubime publike me qytetarë, dhe ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Pejës ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregulloren për transparencën komunale.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, Komuna e Pejës për periudhën e gjashtëmujorit të parë, nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe kërkesë për peticion. Gjithashtu nuk ka pasur raste të deklaratimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, derisa kjo ka ndodhur në rastin e kryetarit të komunës.

Komuna e Pejës nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Pejës gjithashtu është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi. Sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Komuna e Pejës ka dhe Planin për zhvillimin social dhe ekonomik lokal, ndërsa ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

**Efikasiteti i organeve të administratës.** Komuna e Pejës ka nëntë drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 9928 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 9598 ose 96.6%.

Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 5867 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa dhe Ekonomi:** janë pranuar gjithsej 787 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 1449 kërkesa, prej tyre 1222 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 742 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 220 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shërbime Publike:** janë pranuar 184 kërkesa, prej tyre 178 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi:** janë pranuar gjithsej 42 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Inspektion:** janë pranuar gjithsej 511 kërkesa, prej tyre 428 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim:** janë pranuar gjithsej 88 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**ZLK-** janë pranuar gjithsej 28 kërkesa, prej tyre 24 janë shqyrtuar.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Pejës është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësi ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna. NJDNJK nuk ka linjë të veçantë buxhetore.

NJDNJK ka realizuar aktivitete të ndryshme, të cilat dalin nga objektivat e parapara në strategjitë dhe planet e veprimeve për të drejtat e njeriut. Këto kanë të bëjnë me: promovimin e njësitit, shënimin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Formimi i Asamblesë së Fëmijëve, Tryeza e rumbullakët me temën "Të drejtat e grave" etj. Janë realizuar 2 projekte në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe për përmirësimin e pozitës së gruas. Aktivitete të tjera, si fushata vetëdijësuese, tryeza, takime apo trajnime janë mbajtur dy. Ligji për Barazi Gjinore respektohet në tërësi, kjo dëshmohet ngase vërehet përmirësim i pozitës së femrës në vendimmarrje. Janë 7 drejtoresha të shkollave fillore dhe 2 të shkollave të mesme. Me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë NJDNJK janë në kontakt të vazhdueshëm me qendrën e HENDIKOS-it në Pejë, po ashtu anëtarët e njësitit marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesit në panele intervistuese.

NJDNJK bashkëpunon me strukturat e nivelit komunal, dhe institucionet e tjera, vendore dhe ndërkombëtare. NJDNJK ka përgatitur broshura me qëllim promovimin e të drejtave të njeriut.

**Financat lokale.-** Buxheti i aprovuar i Komunës së Pejës, për vitin 2009, është: **12,638,499.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Pejës, kishte planifikuar të hyra

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

në vlerë 1880317,00 €. Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 985703.59 € përkatësisht 52.42%.

Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 janë në vlerë **5,269,711.64 €**.

## KOMUNA E PRISHTINËS

Informacion i përgjithshëm. Territori i komunës së Prishtinës ka një sipërfaqe prej 572 km<sup>2</sup>. Komuna e Prishtinës, ka mbi 470.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 51 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 8 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 529.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. – gjatë periudhës Janar - Qershor 2009, Kuvendi i komunës së Prishtinës, ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 6 mbledhje.

Në këtë komunë, janë themeluar gjashtë komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale por janë krijuar katër komitete tjera. Kuvendi i Komunës, në periudhën e gjashtëmujorit të parë, ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Prishtinës, ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregulloren për transparencën komunale.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Prishtinës për periudhën e gjashtëmujorit të parë ka pranuar ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për peticion. Gjithashtu ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kurse Kryetari nuk ka pasur raste për të paraqitur konfliktin e interesit konform Nenit 59.3 të LVL-së.

Komuna e Prishtinës ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje.

Në komunën e Prishtinës, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Prishtinës ka hartuar Strategjinë dhe Planin për zhvillimin social dhe ekonomik lokal dhe ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.- Komuna e Prishtinës ka 8 drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave ishte gjithsej 19 406, prej të cilave janë shqyrtuar 13 688 ose 70.53 %.

**Drejtoria për Administratë:** janë pranuar 1551 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 1161 kërkesa, ndërsa lëndë të cilat nuk janë shqyrtuar ende janë 250.

**Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 10316 kërkesa, të shqyrtuara gjithsej 8165 kërkesa, lëndë të cilat nuk janë shqyrtuar janë 1558.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 4239 kërkesa. Prej tyre 2985 janë të shqyrtuara, lëndë të cilat nuk janë shqyrtuar janë 757.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 642 kërkesa, të shqyrtuara kemi gjithsej 299 kërkesa, ndërsa të pashqyrtuara janë 253.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 658 kërkesa. Prej tyre 442 kërkesa janë të shqyrtuara, ndërsa të pashqyrtuar janë 170.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** janë pranuar 1394 kërkesa. Prej tyre 599 janë shqyrtuar, ndërsa të pashqyrtuara janë gjithsej 716

**Drejtoria për infrastrukturë Lokale:** janë pranuar gjithsej 216 kërkesa. Prej tyre 37 janë të shqyrtuara, ndërsa të pashqyrtuar janë 154;

**Drejtoria për Pronë** -janë pranuar 390 kërkesa.

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Prishtinës, është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësia ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në komunë, ndërsa nuk ka linjë të veçantë ë buxhetore për njësitin.

Lidhur me zbatimin e objektivave që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për të drejtat e njeriut janë realizuar disa projekte dhe aktivitete si: tryeza e rrumbullakët me temën : “Paqes i duhen gratë, e grave ju duhet drejtësia,” ku temë diskutimi ka qenë Ligji themelor i punës, Ligji mbi familjen, Ligji mbi trashëgiminë; ligjëratë me temën “Barazia gjinore dhe Mjedisi i qëndrueshëm” bashkëpunim me Shoqatën mjedisore “Eko Sfera”; Mbështetjen dhe këshillimin e të rinjve gjatë fazës së anketimit dhe grumbullimit të informatave në komunitet “Kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e financuar nga USAID dhe e zbatuar nga IOM; hartimi i Strategjisë për zhvillim rural; hartimi i programit lokal për PAK; Dita e punësimit të PAK në tetor etj. Si aktivitete të veçanta janë realizuar fushata vetëdijësuese, tryeza dhe takime në fushat: barazi gjinore, mundësi të barabarta, të drejta të fëmijëve, kundër diskriminim, të drejtat e minoriteteve, kundër trafikim etj. Ligji për Barazi gjinore nuk është zbatuar në disa pika, ndërsa Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi.

Përveç gjuhëve zyrtare, gjuhë në përdorim zyrtar është gjuha turke. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve. Komuna ka njësitin për përkthim. Komuna siguron transportin për komunitetin serb. NJDNJK nuk merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës.

NJDNJK bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. NJDNJK ka përgatitur fletëpalosje lidhur me aktivitetet e saj.

Vështirësi kryesore është mungesa e buxhetit.

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Prishtinës, për vitin 2009, është: **42,516,333.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Prishtinës, kishte planifikuar të hyra në vlerë 14,000,000.00 € . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 7595068.79€ përkatësisht 54.25%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **17,057,094.26 €**.

## KOMUNA E PODUJEVËS

***Informacion i përgjithshëm.*** Territori i komunës së Podujevës është me një sipërfaqe një sipërfaqe prej 633 km/2. Komuna e Podujevës, ka mbi 130.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje pre 41 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 7 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 195.

***Funksionimi i Kuvendit të Komunës.*** Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Podujevës, ka mbajtur katër mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej katër mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur pesë mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, por janë krijuar 4 komitete të tjera.

Kuvendi i Komunës, ka mbajtur tubime publike me qytetarë dhe nuk ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Podujevës, nuk ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe rregulloren për transparencën komunale.

Komuna nuk ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Podujevës, për periudhën e gjashtëmujorit të parë ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë apo peticion. Nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit edhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, edhe nga ana e kryetarit të komunës.

Komuna e Podujevës nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera. Në komunën e Podujevës është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Podujevës nuk ka hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal ndërsa ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

***Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.***- Komuna e Podujevës, ka 7 drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 3831 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 3757 ose 98.06%.

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 991 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.



**Drejtoria e Financa Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 281 kërkesa, të shqyrtuara janë 272 kërkesa, të pashqyrtuara 9.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 2228 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim:** janë pranuar 188 kërkesa, të shqyrtuara 90 kërkesa, të pashqyrtuara 98.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 117 kërkesa, të shqyrtuara janë 88 kërkesa, të pashqyrtuara 29.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:** janë pranuar 26 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria e Inspeksionit:** janë pranuar 95 kërkesa, 62 janë shqyrtuar, të pashqyrtuara mbeten 33 kërkesa.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Podujevës, është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësi ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna.

Me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut, NJDNJK ka realizuar projekte dhe aktivitete të ndryshme. Është shënuar 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e fëmijëve, e përcjellë me aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike. Me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, NJDNJK ka organizuar fushata kundër dhunës në familje, kundër dhunës ndaj gruas; është mbajtur një tryezë për diskutimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe për barazinë gjinore në këtë komunë, është diskutuar për të drejtat të fëmijëve; janë informuar nxënësit nëpër shkolla për themelimin e NJDNJK-së.

Sipas Udhëzimit Administrativ për Mundësi të Barabarta është nxjerrë deklarata për mundësi të barabarta dhe me këtë deklaratë janë të njoftuar i tërë shërbimi civil i komunës, gjithashtu është përkthyer edhe në gjuhën serbe.

Zyrtarja për barazi gjinore ka marrë pjesë në panelet intervistuese, si në pozitën e anëtares, ashtu edhe në atë të vëzhgueses. Të gjitha komunitetet i realizojnë të gjitha të drejtat që janë të parapara me ligj. Nuk është evidentuar ndonjë rast të shkeljes së të drejtave të minoriteteve Të gjitha aktet komunale përkthehen në gjuhët zyrtare.

Komuna siguron transportin për të gjitha komunitetet.

NJDNJK konsultohet në procesin e hartimit të rregulloreve dhe është pjesë aktive në fazën e draftimit, si dhe monitoron zbatimin e tyre.

Njësi përballet kryesisht me probleme financiare.

*Financat lokale*.- Buxheti i aprovuar i Komunës së Podujevës, për vitin 2009 është: **11,151,357.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Podujevës kishte planifikuar të hyra në vlerë 981 000, 00 € . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 447986.24€ përkatësisht 45.67%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **4,156,364.75 €**.

## KOMUNA E PRIZRENIT

**Informacion i përgjithshëm.** Territori i komunës së Prizrenit ka një sipërfaqe prej sipërfaqe prej 640 km<sup>2</sup>. Komuna e Prizrenit ka mbi 240.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 41 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 12 drejtori. Ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 302.

**Funksionimi i Kuvendit të Komunës.** - Gjatë periudhës janar - qershor 2009, Kuvendi i komunës së Prizrenit ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe tre mbledhje të jashtëzakonshme. Për këtë periudhë kohore Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur pesë mbledhje. Në këtë komunë janë themeluar katër komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, por janë krijuar edhe shtatë komitete të tjera.

Kuvendi i Komunës, në periudhën e gjashtëmujorit të parë, ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Prizrenit, ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, ndërsa nuk e ka miratuar rregulloren për transparencën komunale. Rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare është në procedurë shqyrtimi.

Komuna e Prizrenit ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Prizrenit për periudhën e gjashtëmujorit të parë ka pranuar ka pranuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për peticion. Gjithashtu ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit edhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, edhe nga ana e kryetarit të komunës.

Komuna e Prizrenit, ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Në komunën e Prizrenit, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin. Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Prizrenit, nuk ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal por ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

**Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.**- Komuna e Prizrenit, ka 12 drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 4225 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 3481 kërkesa, ose 82.4%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë:** janë pranuar 75 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria e Pronës:** ka pasur gjithsej 876 kërkesa dhe ka shqyrtuar 587 prej tyre.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 476 kërkesa, prej tyre 465 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim Urban:** ka pasur gjithsej 650 kërkesa, prej të cilave 507 janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Kadastër:** janë pranuar gjithsej 1315 kërkesa, të shqyrtuara 800.

**Drejtoria për Arsim:** ka pasur gjithsej 130 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 255 kërkesa, të shqyrtuara janë 235 kërkesa.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:** ka pasur gjithsej 140 kërkesa, 118 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Bujqësi:** janë pranuar gjithsej 74 kërkesa, të shqyrtuara janë 60 kërkesa.

**Drejtoria për Inspektion:** janë pranuar gjithsej 182 kërkesa, të shqyrtuara janë të gjitha kërkesat.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** ka pasur gjithsej 52 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**ZKK-** ka pasur gjithsej 46 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Prizrenit është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësi ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna. Zyrtarët e njësitit të të drejtave të njeriut kanë qenë pjesëmarrës së programin për ngritjen e kapaciteteve profesionale të organizuar nga MAPL, të cilët pas përfundimit me sukses janë certifikuar.

Me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga Strategjia dhe Plani I Veprimit për të Drejtat e njeriut, NJDNJK ka realizuar mjaft projekte, aktivitete, tryeza, takime në fushat: barazi gjinore, mundësi të barabarta , të drejtat e fëmijëve, drejtat e minoriteteve etj.

Nga kërkesat e parashtruara në adresën e kësaj zyreje është miratuar kërkesa e TV Opinionit për financimin e një emisioni “Skena Blu” me qëllim të promovimit të barazisë gjinore, vlerave të gruas si dhe vlerave familjare dhe shoqërore.

Në bazë të kërkesës së shoqatës së shurdhëve është dhënë përkrahje e plotë në drejtim të krijimit të kushteve më të qëndrueshme për kryerjen e punëve të tyre. Në këtë drejtim iu është lejuar shfrytëzimi i një lokali afarist në pronësi të Komunës.

Poashtu “Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve” i është dhënë mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të qirasë, rrymës dhe ujit.

Gjatë muajit maj është dhënë përkrahja materiale e aktiviteteve sportive, siç është turniri i basketit me karroca, të cilën e ka organizuar shoqata HENDIKOS me qëllim të promovimit të mundësive të barabarta për PAK.

Aktivitetet e njësitet për të drejtat e njeriut zakonisht mbështeten nga organizatat ndërkombëtare dhe gjatë kësaj periudhe Njësia ka qenë aktive në organizimin e konferencave dhe tryezave në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Problemet janë paraqitur kryesisht kur zyrtarët e të drejtave të njeriut janë obliguar të kryejnë edhe punë tjera shtesë, në kuadër të komunës.

**Financat lokale.-** Buxheti i aprovuar i Komunës së Prizrenit, për vitin 2009 është: **22,481,913.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Prizrenit,, kishte planifikuar të hyra në vlerë 3 948 500,00 € . Për gjashtëmujorin e parë Komuna ka realizuar të hyra 1.942.847 € përkatësisht 49.2%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën 10.187.888 €.

## KOMUNA E RAHOVECIT

Informacion i përgjithshëm. Territori i komunës së Rahovecit ka një sipërfaqe prej 276 km<sup>2</sup>. Komuna e Rahovecit ka mbi 78 674 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 31 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 9 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 138.

**Funksionimi i Kuvendit të Komunës.** – gjatë periudhës janar qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ka mbajtur katër mbledhje të rregullta. Edhe trupat e Kuvendit të Komunës kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej katër mbledhje, ndërsa Komiteti për komunitete nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Në këtë komunë, janë themeluar tre komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale por janë krijuar katër komitete tjera.

Kuvendi i Komunës, në periudhën e gjashtëmujorit të parë, ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Rahovecit, ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për transparencën komunale, rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komuna.

Komuna e Rahovecit ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Rahovecit për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe ka pranuar vetëm një kërkesë për peticion. Nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, gjithashtu edhe Kryetari nuk ka pasur rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Komuna e Rahovecit, nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Rahovecit, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Rahovecit, nuk ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal por ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.- Komuna e Rahovecit ka nëntë drejtori dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, numri i

përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori ishte gjithsej 14149 kërkesa, ndërsa të shqyrtuara janë 13772 ose 97.33% prej tyre. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtorja për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 10 567 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha

**Drejtorja për Buxhet dhe Financa:** ka pranuar gjithsej 535 kërkesa, janë shqyrtuar 332, ndërsa 203 janë të pashqyrtuara.

**Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër, Mjedis dhe Urbanizëm:** janë pranuar gjithsej 2245 kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 2066, të pashqyrtuara janë 179 lëndë.

**Drejtorja për Arsim:** janë pranuar 93 kërkesa, të shqyrtuara janë 67 lëndë, ndërsa të pashqyrtuara kanë mbetur edhe 19 lëndë.

**Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar 556 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport:** ka pranuar gjithsej 31 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural:** ka pranuar gjithsej 68 kërkesa, prej tyre 60 janë të shqyrtuara, ndërsa 8 lëndë ende nuk janë shqyrtuar.

**Drejtorja për Inspektion:** ka pranuar gjithsej 93 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Rahovecit është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësia ka gjithsej pesë zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna. Zyrtarët e njësitet të të drejtave të njeriut kanë qenë pjesëmarrës së programin për ngritjen e kapaciteteve profesionale të organizuar nga MAPL, të cilët pas përfundimit me sukses janë certifikuar. Aktivitetet e njësitetve për të drejtat e njeriut zakonisht mbështeten nga organizatat ndërkombëtare dhe gjatë kësaj periudhe, Njësia ka qenë aktive në organizimin e konferencave dhe tryezave në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Problemet janë paraqitur kryesisht kur zyrtarët e të drejtave të njeriut janë obliguar të kryejnë edhe punë tjera shtesë, në kuadër të komunës.

**Financat lokale.**- Buxheti i aprovuar i Komunës së Rahovecit, për vitin 2009 është: **6,593,736.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Rahovecit,, kishte planifikuar të hyra në vlerë 709 000, 00€ . Për gjashtëmujorin e parë Komuna ka realizuar 275 796.47€ përkatësisht 38.90%.

Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **2,252,286.25 €**.



## KOMUNA E SHTIMES

Informacion i përgjithshëm. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km<sup>2</sup>. Komuna e Shtimes ka mbi 29.000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 21 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 6 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 74.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. – gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Shtimes, ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 4 mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale është krijuar një komitet tjetër.

Kuvendi i Komunës, në periudhën e gjashtëmujorit të parë, nuk ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Shtimes ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për transparencën komunale dhe rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë. Komuna e Shtimes ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Shtimes për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë apo peticion. Ndërkohë ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit, si nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ashtu edhe nga ana e Kryetarit. Komuna e Shtimes nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Shtimes, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Shtimes, nuk ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal por ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

Efikasiteti i administratës së komunës.– Komuna e Shtimes, ka gjashtë drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 1137 kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 1072 ose 94.28%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:



**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar gjithsej 634, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim Hapësinor dhe Mjedis:** janë pranuar gjithsej 316 kërkesa, të shqyrtuara 257, ndërsa të pashqyrtuara janë 59 kërkesa.

**Drejtoria për Ekonomi dhe Financa:** janë pranuar gjithsej 84 kërkesa, të shqyrtuara 81 kërkesa, ndërsa ende nuk janë shqyrtuar 3 kërkesa.

**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Rini dhe Sport:** janë pranuar 18 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Inspektorat:** ka pasur gjithsej 25 kërkesa dhe të gjitha janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Mbrojtje dhe Emergjencë:** janë pranuar gjithsej 60 kërkesa, të shqyrtuara 57 kërkesa, të pashqyrtuara 3 kërkesa.

**Të drejtat e njeriut.** Deri në prill të këtij viti në komunën e Shtimes ka funksionuar NJDNJK e kompletuar me staf e cila ka qenë mjaft aktive dhe përgjegjëse në përmbushjen e detyrave të punës. Mirëpo pas avancimit në pozita tjera udhëheqëse të të dy anëtarëve, NJDNJK-ja pothuajse nuk ka funksionuar deri në muajin korrik kur edhe është ricaktuar koordinatori i NJDNJK-së.

Tani ky njësit ka dy zyrtarë, koordinatorin dhe zyrtarin për komunitete e që të drejtat e njeriut i kanë detyra shtesë.

Nuk kanë linjë të veçantë për aktivitetet e NJDNJK-së. Zyrtarët janë të pajisur me kontrata pune konform Ligjit mbi sherbimin civil.

Për shkak të shpërndarjes së ekipit në detyra tjera NJDNJK-ja e kësaj komune nuk ka pasur aktivitete tjera pos organizimit të takimit me gratë për 8 mars.

Derisa ka qenë njësit i kompletuar njeri nga zyrtarët gjithnjë ka marrë pjesë në panelet intervistuese. Rregulloret dhe aktet tjera komunale monitorohen dhe janë në përputhshmëri me standardet nderkombëtare për të drejtat e njeriut.

Sipas të dhënave Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për të drejtat e komuniteteve dhe Ligji për Përdorimin e gjuhëve, zbatohen në tërësi. Nuk ka njësitë të përkthimit dhe se dokumentet përkthehen kur ka kërkesa të tilla, duke siguruar përkthyes (vetëm statusi i komunës është i përkthyer).

Nuk sigurohet transporti sepse në komunë nuk ka minoritete. Është nxjerrë rregullorja për përdorimin e gjuhëve. NJDNJK-ja ka pasur bashkëpunim të mirë me strukturat komunale si dhe me OSBE-në dhe me OJQ-të tjera. Deri sa ka funksionuar NJDNJK-ja e kompletuar nuk ka pranuar asnjë ankesë nga stafi komunal apo qytetarët për shkelje të drejtave të njeriut.

NJDNJK ka pasur kërkesa gojore sidomos nga komuniteti ashkali për ndihmë rreth sigurimit të dokumenteve, gjë të cilën njësit u ka ofruar.

**Financat lokale.**- Buxheti i aprovuar i Komunës së Shtimes, për vitin 2009 është: **3,234,082.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Shtimes,, kishte planifikuar të

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

hyra në vlerë 310623 € . Për gjashtëmuajin e parë Komuna ka realizuar 110275.57€ përkatësisht 35.50%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **1,263,075.23 €**.

## **Komuna e Skenderajt**

*Informacion i përgjithshëm.* Territori i komunës së Skenderajt, ka një sipërfaqe prej 378 km/2. Komuna e Skenderajt ka mbi 72 mijë banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje pre 31 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në këtë Komunë është 8 drejtori, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 190.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* – Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Skenderajt, ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunave kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur gjashtë mbledhje.

Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitetet konsultative, ndërkaq janë krijuar katër komitete tjera.

Kuvendi i Komunës, në periudhën e gjashtëmujorit të parë, nuk ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Skenderajt, ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për transparencën komunale, ndërsa nuk ka miratuar rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtaren në Komuna.

Komuna e Skenderajt nuk ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Skenderajt për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa ka pranuar një kërkesë për peticion. Ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, po ashtu ka pasur rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e Kryetarit.

Komuna e Skenderajt, nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, por ka lidhur marrëveshje rajonale te bashkëpunimit ekonomik. Në komunën e Skenderajt, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Skenderajt, ka Hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal dhe ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i administratës së komunës.*– Komuna e Skenderajt, ka tetë drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 2463, të shqyrtuara janë 1488 kërkesa ose 60%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 499 kërkesa, prej tyre 338 të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 146 kërkesa, prej të cilave 128 janë të shqyrtuara, 18 të pashqyrtuara .

**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 120 kërkesa. Prej tyre 36 kërkesa janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 84.

**Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sporte:** janë pranuar gjithsej 17 kërkesa, të pashqyrtuara 17.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 1094 kërkesa, prej tyre 790 të shqyrtuara, të refuzuara 8, të pashqyrtuara 296.

**Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari:** ka pasur gjithsej 10 kërkesa, që të gjitha janë të pashqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike dhe Inspektoriat:** janë pranuar gjithsej 431 kërkesa, prej tyre 262 të shqyrtuara, të refuzuara 2, të pashqyrtuara 167.

**Drejtoria e Kadastrës dhe Pronës:** janë pranuar gjithsej 146 kërkesa, prej tyre 12 të shqyrtuara, të pashqyrtuara 134.

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Skenderajt, është themeluar njëسيا për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Në këtë komunë NJDNJK- përbëhet nga tre anëtarë. NJDNJK nuk ka linjë të veçantë ë buxhetore.

Për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut NJDNJK ka hartuar planin e punës dhe ka mbajtur aktivitete, si: manifestimi i 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, shënimi i 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, tryeza të rrumbullakëta dhe debate publike, vizita nëpër shkolla dhe tek familjet e nxënësve që kanë braktisur shkollën, vizitë në çerdhen e fëmijëve, ka vizituar mjediset me popullatë shumë etnike etj.

Deri më tani kanë realizuar katër projekte: Projekti për manifestimin 8 Marsit (ekskursioni 1 ditor) financuar nga komuna; Projekti për manifestimin e 9 majit Ditës së Evropës, financuar nga komuna; Projekti për manifestimin 1 Qershorit Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe Përmirësimi i pozitës së gruas në vendimmarrje në komunë. Në fushën e barazisë gjinore janë organizuar tryeza, diskutime për rolin e femrës në strukturat komunal dhe shtrirja e barazisë gjinore në nivelin rural, avancimi i gruas në punësim, roli i saj në vendimmarrje etj.

Si aktivitet për mundësi të barabarta dhe aktivitete për PAK konsiderohen bashkëpunimi me OJQ-në Hendikos, takimet e përbashkëta për gjetjen e mundësisë për krijimin e kushteve për punësim, arsimim etj.

NJDNJK nuk merr pjesë në panelet intervistuese. Të drejtat e komuniteteve respektohen dhe kohë pas kohë janë organizuar vizita në fshatra me komunitete të përziera, bisedat me qytetarët për problemet dhe nevojat e tyre. Përdorimi i gjuhëve është i rregulluar me statutin e komunës, i cili është i harmonizuar me ligjin përkatës. Njësitë merr pjesë në hartimin e politikave,

rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal si dhe monitoron zbatimin e tyre

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Skenderajt, për vitin 2009 është: **6,185,016.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Skenderajt, kishte planifikuar të hyra në vlerë 425000, 00 € . Për gjashtëmujorin e parë Komuna ka realizuar 187841.15 € përkatësisht 44.20%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **2,934,468.82 €**.

## KOMUNA E SHTËRPCËS

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Shtërpcës ka mbi 13 630 banorë Kuvendi i Komunës, ka një përbërje pre 21 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Numri i drejtorive në Komunën e Shtërpcës është 6, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës së Komunës është 62.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. – Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Shtërpcës, ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta. Trupat e kuvendeve të Komunës për këtë periudhë kohore, konkretisht Komiteti për politike dhe financa Komiteti për komunitete nuk kanë mbajtur mbledhje. Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale dhe nuk janë krijuar komitete tjera.

Kuvendi i Komunës në periudhën e gjashtëmujorit të parë, nuk ka mbajtur tubime publike me qytetarë, por ka miratuar rregulloren për transparencën e punës së Komunës.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Shtërpcës për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për peticion. Nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, derisa ka pasur dy raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e Kryetarit.

Komuna e Shtërpcës nuk ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Në komunën e Shtërpcës nuk është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Shtërpcës nuk ka Hartuar Strategjinë dhe Planin për zhvillimin social dhe ekonomik lokal dhe nuk ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.- Komuna e Shtërpcës ka dërguar raportin për dy (2) drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është 439, të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për arsim dhe kulturë:** janë pranuar gjithsej 16 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë:** janë pranuar gjithsej 423 kërkesa, të gjitha janë të shqyrtuara .

*Të drejtat e njeriut.* Në komunën e Shtërpçës, është themeluar njësi për të drejtat e njeriut sipas kritereve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësia ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna. Zyrtarët e njësimit të të drejtave të njeriut do të jenë pjesëmarrës së programin për ngritjen e kapaciteteve profesionale të organizuar nga MAPL, të cilët pas përfundimit me sukses do të certifikohen. Aktivitetet e njësive për të drejtat e njeriut zakonisht mbështeten nga organizatat ndërkombëtare dhe gjatë kësaj periudhe, Njësia ka qenë aktive në organizimin e konferencave dhe tryezave në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Problemet janë paraqitur kryesisht kur zyrtarët e të drejtave të njeriut janë obliguar të kryejnë edhe punë tjera shtesë, në kuadër të komunës si dhe mungesa e një linje të veçantë buxhetore për NJDNJK-në.

*Financat lokale.*- Buxheti i aprovuar i Komunës së Shtërpçës, për vitin 2009 është: **1,643,373.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Shtërpçës kishte planifikuar të hyra në vlerë 45740, 00€ . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 12788.52 € përkatësisht 27. 96%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **475,129.49 €**.

## KOMUNA E SUHAREKËS

*Informacion i përgjithshëm.* Territori i komunës së Suharekës ka një sipërfaqe prej 362km<sup>2</sup>. Komuna e Suharekës ka mbi 80 000 banorë. Kuvendi i Komunës, ka një përbërje prej 41 anëtarëve, të cilët zgjidhen direkt nga qytetarët. Qeveria komunale, numëron gjithsej 9 drejtori. Ndërsa numri i stafit të lejuar i administratës së Komunës është 134.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.* Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i komunës së Suharekës, ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Edhe trupat e kuvendeve të Komunës, kanë funksionuar dhe për këtë periudhë kohore, Komiteti për politike dhe financa ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje dhe Komiteti për komunitete ka mbajtur 4 mbledhje. Në këtë komunë, nuk janë themeluar komitete konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ndërsa është krijuar 1 komitet tjetër.

Komuna ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komuna.

Kuvendi i Komunës në periudhën e gjashtëmujorit të parë, ka mbajtur tubime publike me qytetarë. Kuvendi i Komunës ka miratuar rregulloren e punës së Kuvendit. Komuna e Suharekës ka miratuar rregulloren për të hyrat vetanake, rregulloren për transparencën komunale dhe rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komune. Komuna e Suharekës ka të miratuar vendimin mbi emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Sa i përket qasjes së dokumenteve zyrtare, Komuna e Suharekës për periudhën e gjashtëmujorit të parë nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, dhe nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për peticion. Ndërsa, ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, edhe nga ana e Kryetarit.

Komuna e Suharekës ka lidhur Marrëveshje me fshatra, vendbanime apo lagje, dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me qytetin e Fellbahut në Gjermani dhe me qytetin Korneugurg të Austrisë, në sferën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës. Në komunën e Suharekës, është krijuar edhe këshilli komunal për siguri në bashkësi, ndërsa sipas afateve të përcaktuara ligjore, Kuvendi i Komunës ka miratuar buxhetin.

Në këtë gjashtëmujor, Komuna e Suharekës ka hartuar Strategjinë dhe Planin, për zhvillimin social dhe ekonomik lokal dhe ka miratuar listën e projekteve prioritare për investime kapitale në Komunë.

*Efikasiteti i organeve të administratës së komunës.*- Komuna e Suharekës, ka nëntë drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 3495



kërkesa, prej të cilave janë shqyrtuar 3108 ose 89%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 476 kërkesa, prej tyre 473 të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 854 kërkesa, prej të cilave 529 janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 569 kërkesa, prej tyre 534 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Arsim:** janë pranuar gjithsej 161 kërkesa, prej të cilave 159 kërkesa janë shqyrtuar.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 1145 kërkesa, prej tyre 1141 të shqyrtuara.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:** ka pasur gjithsej 31 kërkesa, prej të cilave 30 janë të miratuara.

**Drejtoria për Inspektorat:** janë pranuar 113 kërkesa, prej tyre 93 kërkesa janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, Blegtori dhe Zhvillim Rural:** ka pasur gjithsej 146 kërkesa, që të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** ka pasur gjithsej 249, prej tyre 247 janë të shqyrtuara.

**Të drejtat e njeriut.** Në komunën e Suharekës, është themeluar njësi për të drejtat e njeriut dhe funksionon sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi. Njësia ka gjithsej tre zyrtarë, të cilët merren me fusha specifike të të drejtave të njeriut dhe punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të njeriut në Komuna.

Mund të përmenden aktivitetet si vijon: 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve; aktivitete për Ditën e Rinisë, ku janë përfshirë fëmijët, të rinjtë, femrat e reja dhe minoritetet; debati “Gruaja dhe Arsimi”; janë organizuar fushata vetëdijësimi kundër pirjes së duhanit gjatë muajit maj etj.

Ligji për Barazi gjinore nuk zbatohet në të gjitha pikat.

Sa i përket aktiviteteve të NJDNJK-së për mundësi të barabarta dhe PAK vlen të përmendet: Muaji i punësimit për PAK dhe përfshirja e PAK në të gjitha aktivitetet e NJDNJK-së.

Është paraqitur një rast i braktisjes së shkollës, i cili me ndërmjetësimin e NJDNJK-së është kthyer përsëri në shkollë.

Ligji për të drejtat e komuniteteve zbatohet në tërësi. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet plotësisht. Komuna ka nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve. Komuna ka njësi të përkthimit e cila i plotëson nevojat për përkthim.

Komuna siguron transport për të gjitha komunitetet NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i

Komunës si dhe monitoron zbatimin e tyre. Plani i veprimit ka arritur që të zbatohet.

NJDNJK ka bashkëpunim me të gjitha strukturat komunale dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare. Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut, janë paraqitur 3 kërkesa në NJDNJK nga qytetarët e komunës për shkelje të të drejtave të njeriut. NJDNJK ka publikuar në një dokument aktivitetet e veta, me qëllim të njoftimit të publikut. Vështirësitë që ka hasur ky njësit ka të bëjë me mungesën e buxhetit.

***Financat lokale.***- Buxheti i aprovuar i Komunës së Suharekës për vitin 2009 është: **8,061,331.00 €** Për vitin 2009, Komuna e Suharekës kishte planifikuar të hyra në vlerë 1 040 000, 00€ . Për gjashtëmuajorin e parë Komuna ka realizuar 496018.48 € përkatësisht 47.26%. Shpenzimet e buxhetit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2009 kapin vlerën **3,214,246.64 €**

## KOMUNA E VITISË

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Vitisë përbëhet prej 43 vendbanimesh me qendër në Viti, me një sipërfaqe prej 300 km/2. Popullsia prej rreth 60 .000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është nëntë, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 138.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Vitisë ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta, dy mbledhje solemne, si dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe asnjë mbledhje e Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Vitisë ka ngritur pesë komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Vitisë ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës, Rregulloren për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative, po ashtu, është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake, ndërsa nuk ka të miratuar Rregullore komunale për gjuhët.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur tre kërkesa nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, mirëpo nuk ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, apo nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion.

Pranë komunës funksionon arkivi dhe zyra pritëse.

Komuna e Vitisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane brenda territorit të saj, në lidhje me bashkëfinancimin, ndërsa nuk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunat tjera brenda vendit apo jashtë vendit.

Komuna e Vitisë ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Vitisë ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

Efikasiteti i organeve administrative. Komuna e Vitisë ka dërguar raportin për nëntë drejtori. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori është

2189 kërkesa, prej të cilave të shqyrtuara kemi 2052 ose 93.74%. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtorja për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 875 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar gjithsej 239 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar 451 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Arsim dhe Kulturë:** janë pranuar 61 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 247 kërkesa, 113 janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 134.

**Drejtorja për Rini dhe Sport:** nuk ka pasur kërkesa.

**Drejtorja e Inspektionit:** ka pasur gjithsej 171 kërkesa, të shqyrtuara janë 168, të pashqyrtuara janë 3.

**Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** ka pasur gjithsej 145 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtorja e Bujqësisë:** ka pasur gjithsej 15 kërkesa, janë shqyrtuar 11, të pashqyrtuara 4.

**Të drejtat e njeriut.** Në Komunën e Vitisë është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, me tre zyrtarë, të cilët këto detyra i kanë punë shtesë. Zyrtarët janë të certifikuar për vijimin e 20 moduleve të trajnimit, ku përfshihen të gjitha fushat e të drejtave të njeriut.

Kjo Njësi nuk ka linjë të veçantë buxhetore, por aktivitetet e saj realizohen përmes projekteve që financohen nga Kuvendi i Komunës, apo donatorë të ndryshëm. NJDNJK me qëllim të zbatimit të objektivave të parapara në strategjinë dhe planin e veprimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë ndërmarrë rreth 8 projekte dhe aktivitete. Është bërë promovimi i NJDNJK-së përmes takimeve me institucione komunale, debate me të rinjtë, takime me media, botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve për kompetencat dhe përgjegjësitë e NJDNJK-së.

Komuna e Vitisë ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë Negative. Janë ndërmarrë fushata sensibilizimi të opinionit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ligjërata, debate kundër pirjes së duhanit dhe alkoolit; në janar është mbajtur seminari në fshatin Pozhoran ku u prezantuan ligjet e aplikueshme në Kosovë që mbrojnë të drejtat e njeriut; është formuar Komisioni për Mundësi të Barabarta dhe Barazi Gjinore si mekanizëm kontrollues brenda komunës në fushën e mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore; me rastin e 8 Marsit është organizuar tryeza “Barazia Gjinore, një sfidë për të ardhmen”; është hartuar Strategjia Komunale për

Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje – Plani i Veprimit 2009 – 2014 (është duke u përgatitur drafti final); Hartimi i Strategjisë komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe janë ndërmarrë shumë aktivitete të tjera nga fusha e të drejtave të njeriut e në veçanti për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe të drejta të fëmijëve.

Me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta janë ndërmarrë disa aktivitete dhe projekte si: Organizimi i kampingut për fëmijë me aftësi të kufizuara; Projekti për furnizim me mjete korrektuese për paralelet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollën “ Faik Konica”; Rekomandime për trajtim të barabartë të qytetarëve dhe shërbyesve civil etj. Sa i përket aktiviteteve për të drejtat e fëmijëve janë organizuar debate me të rinj, radio debate, kamping multietnik i fëmijëve në Brezovicë etj.

Për promovimin e të drejtave të minoriteteve janë mbajtur takime me qytetarët nga komuniteti pakicë nga Kryetari i KK-së dhe stafi i tij. Nuk ka ndonjë rast të shkeljes së të drejtave të komuniteteve

Ligji për Përdorimin e gjuhëve zbatohet në tërësi. Të gjitha dokumentet përkthehen në të dy gjuhët. Komuna siguron transportin për të gjitha komunitetet. NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal si dhe monitoron zbatimin e tyre.

NJDNJK bashkëpunon me të gjitha strukturat komunale, organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.

**Financat lokale.** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Vitisë është 6,058,608.00 euro. Për gjashtëmujorin e parë të vitit janë shpenzuar 2,435,421.32 ose 40%.

Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 490,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 308,398.99 ose 62.94%.

## KOMUNA E VUSHTRISË

Informacion i përgjithshëm. Komuna e Vushtrrisë, shtrihet në një sipërfaqe prej 344 km/2. Popullsia prej rreth 103.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 31 anëtarë. Numri i drejtorive është nëntë, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 170.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës. Gjatë periudhës janar-qershor 2009, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjashtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjashtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Sipas informacionit që ka në dispozicion MAPL, rezulton se Komuna e Vushtrrisë nuk ka ngritur komitete konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të këtij viti Komuna e Vushtrrisë ka organizuar tubime publike me qytetarët. Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës. Është në proces shqyrtimi Rregullorja për gjuhët. Ndërkohë që Komuna nuk ka një Rregullore për transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative. Është miratuar Rregullorja për të hyrat vetanake.

Nga të dhënat që kemi në dispozicion, gjatë kësaj periudhe ka pasur një kërkesë nga qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare, si dhe ka pasur kërkesa dhe peticione nga qytetarët e Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 nuk ka pasur raste të paraqitjes të konfliktit të interesit nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, apo nga kryetari i Komunës. Kryetari i Komunës ka raportuar një herë para Kuvendit të Komunës, sipas të dhënave në dispozicion. Pranë komunës funksionon arkivi dhe zyra pritëse. Komuna e Vushtrrisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane brenda territorit të saj.

Po ashtu, kjo komunë ka miratuar Vendimin mbi emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike. Komuna e Vushtrrisë ka themeluar dhe Këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Komuna e Vushtrrisë ka miratuar buxhetin komunal brenda afatit ligjor të përcaktuar, ndërkohë që është miratuar edhe lista e projekteve prioritare për investimet kapitale. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë nuk ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin social-ekonomik lokal.

Efikasiteti i organeve administrative. Komuna e Vushtrrisë ka dërguar raportin për nëntë drejtori, ndërkohë që vetëm shtatë prej tyre kanë paraqitur të dhëna. Numri i përgjithshëm i kërkesave në këto drejtori, është 3596 kërkesa, ndërsa të shqyrtuara janë 3199 ose 88.96% prej tyre. Numri i saktë i kërkesave për secilën drejtori është paraqitur si vijon:

**Drejtoria për Administratë dhe Personel:** janë pranuar 836 kërkesa, të gjitha të shqyrtuara.

**Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:** janë pranuar 184 kërkesa, prej të cilave 107 janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 77.

**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit:** janë pranuar gjithsej 271 kërkesa. Prej tyre 234 kërkesa janë të shqyrtuara, të pashqyrtuara 37.

**Drejtoria për Arsim:** janë pranuar gjithsej 351 kërkesa, prej të cilave 320 kërkesa janë shqyrtuar, të pashqyrtuara 31.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** janë pranuar gjithsej 807 kërkesa, prej tyre 605 të shqyrtuara.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:** ka pasur gjithsej 68 kërkesa, prej të cilave 61 kërkesa janë të miratuara, të pashqyrtuara 7.

**Drejtoria për Bujqësi dhe Inspektion:** ka pasur gjithsej 592 kërkesa, që të gjitha janë të shqyrtuara.

**Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike:** nuk ka të dhëna.

**Drejtoria e Prokurimit:** nuk ka të dhëna.

Të drejtat e njeriut. Në Komunën e Vushtrrisë është themeluar dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut me tre zyrtarë, të certifikuar për vijimin e 20 moduleve të trajnimit, ku përfshihen të gjitha fushat e të drejtave të njeriut. Zyrtarët e njësisë, njëkohësisht janë të angazhuar edhe me punë tjera shtesë në Kuvendin e Komunës.

Me qëllim realizimin e objektivave që dalin nga strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut janë kryer disa aktivitete, si: Shënimi i 1 Qershorit (Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut), festimi i 8 Marsit, si dhe me 26 qershor janë mbajtur takime me qytetarë, në lidhje me të drejtat e njeriut, takime të financuara nga Kuvendi i Komunës, është mbajtur një bisedë në viset rurale për barazi gjinore.

Ligji për Barazi Gjinore zbatohet relativisht mirë.

Nuk ka pasur raste të shkeljes të drejtave të fëmijëve, si dhe nuk është shënuar ndonjë rast i braktisjes së shkollimit nga ana e fëmijëve.

Ligji për të Drejtat e Komuniteteve zbatohet në tërësi. Me qëllim të promovimit të drejtave të minoriteteve është mbajtur takim me ta. Nuk ka pasur ndonjë rast të shkeljes së të drejtave të minoriteteve.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve zbatohet në tërësi. Rregullorja për përdorimin e gjuhëve është në miratim e sipër. Komuna e ka njësitin për përkthim, i cili i



plotëson të gjitha nevojat për përkthim. Komuna siguron transportin për të gjitha minoritetet. NJDNJK merr pjesë në hartimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga kuvendi komunal NJDNJK ka bashkëpunim me të gjitha strukturat komunale. NJDNJK ka përgatitur dokument publik lidhur me aktivitetet e saj, mirëpo ende nuk është botuar.

*Financat lokale.* Buxheti i aprovuar i Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2009 është: **8,110,857.00 €** Për vitin 2009, buxheti i aprovuar për Komunën e Vushtrrisë është 8,110,857.00 euro. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit janë shpenzuar 3,362,637.97 ose 41%. Kjo komunë ka planifikuar të hyra vetanake në shumën 560,000.00 euro. Për periudhën e raportimit janë realizuar të hyra në shumën 437,304.92 ose 78.09.27%.



## **KOMUNA E ZUBIN POTOKUT**

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë përbëhet prej 64 vendbanimesh me qendër në Zubin Potokut, me një sipërfaqe prej 335 km/2. Popullsia prej rreth 15.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 17 anëtarë. Numri i drejtorive është gjashtë, ndërsa numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 113.

*Funksionimi i Kuvendit të Komunës.*

Nuk ka informacion.

*Efikasiteti i organeve administrative*

Nuk ka informacion.

## **Komuna e Zveçanit**

*Informacion i përgjithshëm.* Kjo komunë përbëhet prej 35 vendbanimesh me qendër në Zveçan, me një sipërfaqe prej 104 km/2. Popullsia prej rreth 17.000 banorë. Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është 17 anëtarë. Numri i drejtorive është katër, ndërsa, numri i lejuar i stafit të administratës komunale është 63.

### *Funksionimi i Kuvendit të Komunës.*

Nuk ka informacion.

### *Efikasiteti i organeve administrative*

Nuk ka informacion.

Shtojca:

1. Tabela e funksionimit të Kuvendeve të Komunave dhe trupave të tyre, janar-qershor 2009;
2. Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, të krahasuar në gjashtëmujorin e parë 2008, gjashtëmujorin e dytë 2008 dhe gjashtëmujorin e parë 2009;
3. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunave




MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

Shtojca 2.

Numri i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, të krahasuara në tre gjashtëmujorë:

Komunat e Republikës së Kosovës	Nr. i mbledhjeve për gjashtëmujorin e parë 2008	Nr. i mbledhjeve për gjashtëmujorin e dytë 2008	Nr. i mbledhjeve për vitin 2008	Nr. i mbledhjeve për gjashtëmujorin e parë 2009
Deçan	5	7	12	5
Dragash	5	5	10	5
Ferizaj	7	4	11	5
Fushë Kosovë	5	5	10	6
Gjakovë	4	6	10	6
Gjilan	6	5	11	5
Glogoc	5	5	10	5
Hani i Elezi	4	6	10	6
Istog	5	5	10	5
Junik	4	6	10	6
Kaçanik	5	5	10	6
Kamenicë	6	4	10	5
Klinë	5	5	10	6
Leposaviq	--	--	--	--
Lipjan	6	6	12	6
Malishevë	7	4	11	5
Mamushë	5	7	12	6
Mitrovicë	6	8	14	4
Novo Bërdë	5	3	8	6
Obiliq	4	5	9	4
Pejë	5	6	11	6
Podujevë	6	2	8	4
Prishtinë	6	6	12	5
Prizren	7	5	12	5
Rahovec	5	6	11	4
Shtërpcë	0	2	2	2
Shtime	6	6	12	6
Skenderaj	5	5	10	6
Suharekë	5	6	11	6
Viti	4	6	10	5
Vushtrri	5	6	11	5

Paraqitja në mënyrë grafike e shpenzimeve komunale sipas kategorive ekonomike për periudhën janar-qershor 2009



		<b>Buxheti i aprovuar 2009</b>	<b>Buxheti i shpenzuar janar qershor 2009</b>	<b>Të hyrat vetanake</b>	<b>Të hyrat 2008</b>	<b>Totali i shpenzime ve</b>	<b>Indek s</b>
	GJITHSEJ BUXHETI I KOMUNA VE	243,400,000.0 0	86,698,697.40	5,707,374.55	9,797,899.1 6	102,203,971. 11	42
a	<i>Rrogat dhe pagat</i>	126,080,232.0 0	62,968,541.30	480,484.05	362,421.83	63,811,447.1 8	51
b	<i>Mallrat dhe shërbimet</i>	24,336,593.00	7,305,790.48	668,253.03	2,214,391.5 1	10,188,435.0 2	42
c	<i>Shpenzim et komunale</i>	8,621,360.00	3,471,386.57	15,001.01	112,988.88	3,599,376.46	42
d	<i>Subvencio ne dhe transfere</i>	3,091,985.00	188,587.95	1,495,568.87	375,805.54	2,059,962.36	67
e	<i>Shpenzim et kapitale</i>	81,269,831.00	12,764,391.10	3,048,067.59	6,732,291.4 0	22,544,750.0 9	28

## Rishqyrtimi i akteve të Komunave nga MAPL

MAPL, duke u bazuar në mandatin e saj ligjor, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbikëqyr ligjshmërinë e akteve të Komunave. Për periudhën Janar-qershor 2009, MAPL rregullisht ka shqyrtuar ligjshmërinë e rregulloreve dhe vendimeve të komunave. Vendimet e listuara si vijon janë kthyer në rishqyrtim nga MAPL.

- Rishqyrtimi i Vendimit të KK-Viti NR 01-13/4608 mbi kthimin e të gjitha pronave të paluajtshme shoqërore titullarit të mëparshëm përkatësisht Kuvendit të Komunës së Vitisë. Duke u bazuar në Ligjin për Agjensionin Kosovar të Privatizimit, kompetent për të menaxhuar dhe administruar këto prona është AKP. Lidhur me këtë, Komuna e Vitisë nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të rishqyrtuar Vendimin Nr 01-03/4608;
- Rishqyrtimi i vendimit të KK- Malishevë Nr 01/85 për dhënien në shfrytëzim për 30 vite të pronës shoqërore. Duke u bazuar në Ligjin për Agjensionin Kosovar të Privatizimit, kompetent për të menaxhuar dhe administruar me këto prona është AKP. Në këtë rast Komuna e Malishevës ka rishqyrtuar këtë vendim dhe ka vendosur që këto prona të mos jepen në shfrytëzim për 30 vite, por të jepen për 10 vite me mundësi vazhdimi të shfrytëzimit;
- Rishqyrtimi i nenit 7 dhe 108 të Statutit të Komunës së Mamushës me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Komuna e Mamushës ende nuk e ka rishqyrtuar kërkesën e MAPL-së për harmonizimin e statutit me ligjin për përdorimin e gjuhëve;
- Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Nr 01-01461/09 për ndarjen e njësisë së Ndërmarrjes Regionale Bifurkacioni. Kjo



komunë ka rikthyer në Kuvendin Komunal këtë vendim, por Kuvendi Komunal nuk e ka ndryshuar vendimin;

- Rishqyrtimi i Vendimit të KK - Dragash Për ndryshimin e Emblemës së Komunës. Vendimi për ndryshimin e emblemës së komunës është nxjerrë në kundërshtim me nenin 7.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Autoritetet Lokale kanë shprehur gatishmëri për rishqyrtim të vendimit dhe harmonizim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Komuna e Dragashit, në përputhje me kërkesën e MAPL-së, ka rikthyer në votim vendimin për emblemën, dhe ka miratuar emblemën ashtu siç parashihet me ligj;
- Rishqyrtimi i vendimit të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, me të cilin është obliguar menaxhmenti i Aeroportit Ndërkombëtar "Prishtina" të ndalojë operimin të gjitha auto taksive që nuk janë të regjistruar në Komunën e Lipjanit. MAPL ka kërkuar rishqyrtimin e këtij akti. Komuna e ka rishqyrtuar vendimin;
- Kërkesë për zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nga autoritetet lokale të Komunës së Podujevës. Është kërkuar nxjerrja e akteve që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, funksionalizim i komiteteve obligative në komunë, vazhdimi i mbledhjeve të rregullta që janë ndërprerë dhe përjashtimi i rasteve të konfliktit të interesit. Komuna e Podujevës ka përmbushur të gjitha obligimet ligjore, me përjashtim të miratimit të statutit.

## Konkluzione:

### *Funksionimi i Kuvendeve të Komunave*

- *Shumica e Komunave janë brenda dinamikës së parashikuar për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale, në përputhje me nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Nga të gjitha Komunitet e Republikës së Kosovës, obligimin ligjor për mbajtjen e pesë mbledhjeve në gjashtëmujorin e parë nuk e kanë përmbushur: Obiliqi, Podujeva, Klinë, dhe Rahoveci të cilat kanë mbajtur nga 4 mbledhje dhe Shtërpca që ka mbajtur 2.*
- *Komitetet e detyrueshme janë formuar gati në të gjitha komunat. Përjashtim bën komuna e Shtërpçës, e cila nuk e ka formuar komitetin për politikë dhe financa dhe Komitetin për komunitete. Gjithashtu, edhe komuna e Glogocit nuk ka themeluar komitetin për komunitete. Aktivitet më dinamik ka pasur Komiteti për Politikë dhe Financa për dallim nga komitete tjerat. Gjithashtu vërehet se Komunitet nuk kanë themeluar komitetet konsultative, ashtu siç i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Vetëm disa komuna kanë krijuar këto komitete, të cilat janë listuar si vijon: : Peja(4), Rahoveci, Gjakova, Prizreni, Kaçanik(4), Obiliqi(4), Prishtina(5), Viti (5).*
- *Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, ekziston një numër i caktuar i Komunave të cilat nuk kanë mbajtur tubime publike me qytetarë. Vetëm 22 Komuna kanë mbajtur tubime publike. Sipas të dhënave që janë siguruar nga Komunitet, komuna e Ferizajt, Istogut, Klinës, Mitrovicës, Pejës, Shtërpçës, Shtimes dhe Skenderajt nuk kanë mbajtur tubime publike*
- *Një numër i konsiderueshëm i Komunave kanë miratuar statutet e tyre dhe i kanë harmonizuar me LVL. Vetëm komuna e Podujevës dhe Shtërpçës nuk i kanë miratuar statutet e tyre. Gjithashtu Komunitet kanë pasur aktivitetet e tyre legjislative megjithëse një numër i konsiderueshëm i Komunave akoma nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore. Për shembull, vetëm 16 komuna kanë miratuar rregulloret për përdorimin e gjuhëve dhe vetëm 20 Komuna, kanë miratuar rregulloren për transparencën e punës së Komunës. Rregulloren për*

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

*punën e kuvendit e kanë miratuar të gjitha komunat, me përjashtim të komunës së Shtërpcës. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i komunave nuk janë të disiplinuar të zbatojnë rekomandimet e MAPL-së nga raporti i Komunave për vitin 2008, në aspektin e dërgimit të rregulloreve në MAPL, me qëllim të vlerësimit të lidhshmërisë. Me këtë rast, ekipet e monitorimit të MAPL-së rregullisht janë detyruar të bëjnë vizita në Komuna, me qëllim të mbledhjes së rregulloreve dhe vendimeve.*

- *27 Komuna kanë krijuar këshillat komunal për siguri në bashkësi;*
- *Një numër i konsiderueshëm i komunave kanë miratuar vendimet për emërtimet e rrugëve dhe shesheve. Vetëm Komuna e Klinës, Shtërpcës, Skenderajt dhe Hani i Elezit.*
- *Një numër i konsiderueshëm i Komunave të Republikës së Kosovës, kanë miratuar planet për zhvillim social-ekonomik lokal. Nëntë Komuna nuk e kanë miratuar strategjinë, konkretisht, Komuna e Ferizajt, Fushë-Kosovës, Kaçanikut, Novobërdës, Prizrenit, Rahovecit, Shtimes, Shtërpcës dhe Vushtrrisë. Nga të dhënat që MAPL ka në dispozicion, vihet re se nuk është përdorur metodologji unike për hartimin e strategjive për zhvillimin socio-ekonomik të Komunave;*

### ***Efikasiteti dhe Azhureteti i administratës së Komunave***

- *Gjatë analizimit të të dhënave për efikasitetin dhe azhuretetin në administratën komunale, vërehet se të dhënat janë paraqitur në mënyrë të pasaktë. Një numër i konsiderueshëm i komunave, tek numri i kërkesave në procedurë administrative në shkallë të parë, kanë numëruar edhe dokumentet e gjendjes civile.*
- *Të dhënat në zyrën pritëse në shumicën e Komunave nuk azhurnohen me kohë;*
- *Sistemi digjital (Intraneti) në zyrën pritëse në Komunë është i instaluar, por të dhënat nuk freskohen dhe ka vështirësi në kthimin e dokumentacionit në këtë zyrë;*
- *Në librat e protokollit të shkurtër evidentohen pranimet e kërkesave, ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës, Libri i protokollit nuk plotësohet, por për kërkesat dhe parashtrësat e qytetarëve, mbahen libra të brendshëm nëpër drejtori;*
- *Komunat nuk kanë përmbushur rekomandimet e MAPL-së nga raporti I vitit 2008, për të respektuar procedurat që parashihen me Udhëzimin Administrativ për funksionimin e Zyrave pritëse.*

*Të drejtat e njeriut*

- *Njësitet e të drejtave të njeriut janë funksionale në 26 komuna të Republikës së Kosovës;*
- *Zyrtarët e NJDNJK-së monitorojnë përputhshmërinë e respektimit të akteve komunale me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (një numër i konsiderueshëm kryen këtë përgjegjësi, mirëpo ka komuna që asnjëherë nuk janë angazhuar si: Novobërda).*
- *NJDNJK-të Monitorojnë aktivitetet e komunës dhe këshillojnë zyrtarët komunal sa i përket respektimit së të drejtave të njeriut;*
- *Të gjitha komunat kanë hartuar planin e veprimit të përcjellë me koston financiare, mirëpo realizimi i këtyre planeve është i pjesshëm për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore;*
- *Shumica e NJDNJK-ve koordinojnë aktivitetet me departamentet komunale si me të gjitha drejtoratet komunale, zyrtarët komunal, institucionet qendrore, organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të lehtësimit të realizimit të objektivave të veta.*
- *Kërkesat që u janë adresuar NJDNJK-së nga qytetarët më tepër kanë qenë kërkesa verbale sesa me shkrim. Kërkesat kanë qenë të ndryshme si: kërkesa për zgjidhjen e problemit të kujdesit prindëror (Istog), kërkesa për zgjedhjen e problemit të ndërprerjes së ndihmës sociale, kërkesa për rregullimin e dokumentacionit, kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit etj. Kërkesat apo ankesat që i janë adresuar NJDNJK-së, janë shqyrtuar nga njësi, pastaj janë adresuar në institucionet kompetente për zgjidhjen e atyre rasteve. Në të shumtën e rasteve rekomandimet e NJDNJK-së kanë gjetur mirëkuptim nga organet kompetente për zgjidhjen e atyre rasteve. Po ashtu palët janë ndihmuar nga njësi për paqartësitë e ndryshme me cilat ata janë përballur në kontekst të të drejtave të njeriut.*
- *Pothuajse të gjitha komunat kanë bërë publike aktivitetet e tyre;*
- *Vështirësi kryesore e NJDNJK-ve komunale është, përkrahja jo e mjaftueshme nga zyrtarët e lartë komunal, vartës të tyre, mungesa e një linje të veçantë buxhetore, vështirësi tjetër është ngase zyrtarët në këto njësi detyrat nga fushat e të drejtave të njeriut kryesisht i kanë punë shtesë.*

## Rekomandime

- Komunat të cilat nuk kanë përmbushur obligimet ligjore për mbajtjen e tubimeve publike me qytetarë, numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, formimin e komiteteve konsultative ashtu siç parashihet me ligjin për vetëqeverisje Lokale, të ndërmarrin veprime në drejtim të përmbushjes së këtyre obligimeve ligjore;
- Të miratohen rregulloret për përdorimin e gjuhëve në nivelin lokal dhe rregulloret për transparencën e komunave, në Komunat të cilat nuk janë miratuar;
- Drejtoritë komunale duhet të hartojnë planet e punës për vitet në vijim (planet duhet të jenë të detajuara në vite, muaj dhe javë);
- Të shihet mundësia e hapjes së zyrave të vendit në lokalitetet e mëdha në mënyrë që tu ofrohen shërbime sa më afër qytetarëve;
- Kërkohet nga komunat të cilat ende nuk i kanë hartuar planet për zhvillim ekonomik social që këtë gjë ta bëjnë në një afat të arsyeshëm kohor;
- Në mënyrë që aktivitetet e komunës të jenë sa më transparente para qytetarëve, rekomandohet funksionalizimi i faqeve zyrtare të Komunave; rifreskimi i të dhënave në të dy gjuhët; freskimi i të dhënave me kohë dhe publikimi i rregulloreve komunale në gjuhët zyrtare, sipas rekomandimeve të dhëna në raportin e funksionimit të faqeve zyrtare të Komunave;
- Rekomandohet që në të ardhmen Komunat të kenë në dispozicion të dhëna të sakta për numrin e kërkesave në procedurë administrative dhe të mos përfshijë tek statistikave edhe numrin e dokumenteve të gjendjes civile;
- Të hyjë në funksionim zyra pritëse sipas Udhëzimit Administrativ të MAPL-së;
- Në librat e protokollit të shkurtër (intern) të bëhet evidentimi i pranimeve të kërkesave ndërsa pas shqyrtimit përsëri të kthehen në zyrat pritëse;

## MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

- Të instalohet sistemi digjital (Intraneti) në zyrën pritëse në Komunë dhe pas vendosjes së kërkesave, përgjigja të kthehet përmes zyrës pritëse, ashtu siç kërkohet me UA;
- Me qëllim të tejkalimit të vështirësive dhe lehtësimit të punëve të NJDNJK-ve komunale, rekomandojmë që këtyre njësiteve tu krijohen kushte për punë, konform kërkesave elementare që i kanë, siç janë: qasja në internet, telefona fiks, transporti me rastin e pjesëmarrjes së tyre në trajnime dhe takime të ndryshme;
- Të krijohet një bashkëpunim dhe koordinim më i ngushtë ndërmjet NJDNJK-së dhe organeve tjera komunale si: drejtoritë komunale, zyrën ligjore si dhe të kërkohet nga këto të fundit që të ketë konsulta me NJDNJK-në lidhur me çështjen e të drejtave të njeriut;
- Të krijohen njësitë e veçanta për përkthim për arsye se disa komuna kanë vetëm nga një zyrtar për përkthim, i cili nuk mund të plotësojë kërkesat për përkthim;

- Raporti i kompletuar është hartuar nën mbikëqyrjen e Rozafa Ukimeraj, Drejtoreshë e Departamentit për Vetëqeverisje Lokale dhe Enton Elezi këshilltar CDF;
- Të dhënat nga Komunat u mblodhën nga zyrtarët e Divizionit të Monitorimit të Komunave nën përkujdesjen e Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit;
- Pjesa e të drejtave të njeriut është hartuar nën përkujdesjen e Fakete Kuka, Udhëheqëse e Divizionit për të Drejtat e Njeriut;
- Pjesa e legjisllacionit është përgatitur nën përkujdesjen e Agron Maxhuni, Drejtor i Departamentit Ligjor;
- Pjesa financiare e raportit është përgatitur nën përkujdesjen e Besim Kamberaj, Drejtor i Departamentit për Reformë dhe Integritet Evropian;
- Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në raport janë përgjegjëse Komunat e Republikës së Kosovës;
- E Drejta autoriale e këtij raporti i takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.